

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7482 E enjte 29 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**

**B**abi, babi, ule shpejtësinë, më thotë djali im Joani, sa herë që nisem për të shkuar në Durrës apo diku tjetër edhe pse unë i zbatoj më së miri kërkesat e Kodit...

Vijon në faqen 21

Nga FISNIK ZIÇISHTI

**Ditët e zisë!**



**Opinion** *i* **Ditës**

**C**ësht krimi? Kush është kriminel? A duhet dënuar krimi? Përse duhet dënuar kriminel? Këto pyetje të thjeshta janë, në të vërtetë, thelbësore për një...

Vijon në faqen 20

Nga Besim NDRREGJONI

Bëhu dhe ti kontribues në gjetjen e eshtrave të të zhdukurve se je shqiptar!



Skandali me pronat në bregdet, 10 zonat problematike

## Lame: Në verifikim 30 mijë parcela, ja kush "digjet", 4 rrugët e paligjshme

"Gjithë bregdeti i jugut është i parregjistruar. Tokat e Alket Hysenajt? Janë brenda vijës"

Nga ORNELA MANJANI  
Kryetari i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, ALU-IZNI, Artan Lame, deklaroi se i gjithë bregdeti i jugut është i parregjistruar. Në një bashkëbisedim me gazetarët, Lame tha se, "në këto 27 vite i gjithë..."

## ZBARDHET VENDIMI I QEVERISE, PJESE E SHERBIMIT MUND TE BEHEN MESHKUJZ DERI 50 VJEÇ

# USHTARAKET NE REZERVE PROCEDURAT PER GRADAT

Kriteret që duhet të plotësojnë të interesuarit. Koloneli për të fituar gradën gjeneral brigade/ kundëradmiral", të këtë shërbyer jo më pak se 5 periudha vjetore



(Në foto) Foto ilustruese

**VETINGU**

**10 gjyqtarët e prokurorët që i shpëtojnë vetingut Rama: S'e ndal balta**

Në faqen 3

**ISH-TE PERNDJEKURIT**

**Ndryshon ligji për dëmshpërblimet, 1 vit burg do t'u njihet si 2 vite pune**

Në faqen 6

**VENDIMI**

**Helmoi vjehrrën me fostoksinë, Apeli lë në burg Marjana Cmetën**

Në faqen 9

**PERFITUESIT E ATP**

**Lista III/ Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që do të kompensohen**

Në faqet 14-16

**MJEKU POPULLOR**



**Ylli Merja: Si të kuroni alergjitë e stinës me bimë mjekësore, simptomat**

Në faqen 12

DEBATET NE KUVEND/ Opozita "gozhdon" Kumbaron, ministrja: Është vetëm propozim

## "Teatri", shkrimtari Erebara: Shkatërruan çdo gjë

"E mbroj se ata që do vdisnin për teatrin, ndërruan mendje dhe pëlqejnë projektin"

Nga FATMIRA NIKOLLI  
Më mbetet dilemë: si ka mundësi që kthyen aktorët e regjisorët tanë më të nderuar brenda një nate, nga "do të vdesim për teatrin" në "na pëlqen projekti". Këtu nuk ka si të mos shkojë mendja se qeveria u bëri presion".



Shkrimtari Rudi Erebara lajmëroi të martën një protestë qytetare para Teatrit Kombëtar për mbrojtjen e godinës historike. Pak orë më vonë, ai do të njoftonte se aktorët janë kërcënuar që të mos dalin në protestë. E, megjithatë, një grusht qytetarësh...

Në faqet 18-19

# VETINGU AKUZAT


Alibeaj: Urdhër arresti për kreun e policisë Vlorë, por jo për ish-ministrin e Brendshëm

# PD publikon prova të reja për lidhjen e Tahirit me bandën "Habilaj"

## "Ja eld Çela dekonspiroi operacionet e SHISH"

Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje prova të reja që implikojnë ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, në përfshirjen e tij në trafikun e drogës Shqipëri-Itali dhe lidhjen me grupin "Habilaj". Sipas deputetit demokrat, Enkelejd Alibeaj, duke iu referuar vendimit të plotë të Gjykatës së Krimeve të Rënda për ish-drejtorin e Policisë së Vlorës dhe shefin e Antidrogës në këtë qytet, tha se ky aktivitet kriminal funksiononte me mbështetjen e Jaeld Çelës, i shpallur në kërkim. Sipas opozitës, dokumentet provojnë se Çela ka dekonspiruar operacionet e SHISH-it për llogari të bandës së Habilajve. "Është fakturi të paktën prej katër muajsh se lidhja midis ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri dhe trafikantëve të drogës, bandës së Habilajve, mbahej edhe nëpërmjet drejtorit të Policisë së Vlorës, Jaeld Çela, i cili është shpallur në kërkim si bashkëpunëtor në trafikun ndërkombëtar të drogës. Rezultoni se policia jo vetëm ishte roje e trafikut, por edhe se drejtori i policisë, Jaeld Çela ka dekonspiruar operacionet e SHISH për llogari të Habilajve", theksoi z. Alibeaj. Sipas deputetit demokrat, në një dokument prej 18 faqesh që PD e disponon, tregohen bisedat dhe mesazhet mes Habilajve dhe drejtuesve të policisë Vlorë. Demokratët shprehën se ish-ministri i Brendshëm ka qenë garancia politike për kultivimin dhe trafikimin e kanabisit nga banda e Habilajve. Sipas tyre, është e pakuptimtë që përballë dokumenteve e provave për ish-drejtorin e Policisë së Vlorës, Jaeld Çela ka kërkesë për arrest



Faksimile e dokumentave të PD-së për lidhjet e Tahirit me Habilajt

### FAKTET

"PD disponon dokumentet zyrtare që e provojnë këtë lidhje. Kjo është masa e sigurisë arrest me burg e vendosur nga Gjykata e Krimeve të Rënda për 2 oficerët e lartë të policisë, Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila, shef i Antidrogës në Vlorë, me akuzën e pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, kultivim dhe trafikim të kanabisit".

### BISEDAT

"Bisedat mes drejtuesve të bandës së Habilajve dhe drejtuesve të Policisë së Vlorës provojnë se policia jo vetëm ishte kthyer në roje të transportit të kanabisit drejt Italisë, por Jaeld Çela ka dekonspiruar operacionet e SHISH për llogari të Habilajve, që vetë trafikantët në përgjime i quajnë "kusho të ministrit".



### PETRIT VASILI

Kreu i deputetëve të LSI, Petrit Vasili, akuzoi kryeministrin Rama si një gënjeshhtar të paepur lidhur me 613 kg kokainë të sekuestruar pak javë më parë në Portin e Durrësit. "Të gjithë shqiptarët e dëgjuan se çfarë tha ai për 613 kg kokainë për mbështetjen e ndërkombëtarëve lidhur me kapjen e saj. Që Rama është gënjeshhtar i paepur dhe që gënjeshtrën e ka mënyrë jetese po jua lë juve ta gjykonin. Por është halli i madh, që do merret vesh shpejt, që e detyron të gënjëjë", tha Vasili.



Kontingjenti e 7 i FA, pjesë e misionit të NATO-s

## Xhaçka në Izmir: Përmirësim, trajtimit financiar e njerëzor

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka vizitoi dje kontingjentin e 7 të Forcës Detare, pjesë e misionit të NATO-s në Detin Egje. Gjatë fjalës së saj, Xhaçka theksoi se qeveria shqiptare është e fokusuar në trajnimin dhe karrierën e punonjësve, duke pranuar në të njëjtën kohë se trajtimi financiar që u jepet nuk është ai që ata meritojnë. "I gjithë fokusi ynë, i gjithë përqendrimi ynë në këtë moment është tek edukimi, trajnimi dhe të karriera e gjithsecilit prej jush, që për hir të së vërtetës bëni një punë me kufizime dhe shumë sakrificave, por një punë të jashtëzakonshme, që do t'u lini trashëgimi shumë të rëndësishme brezave, duke ofruar siguri për vendin tonë dhe duke kontribuar për pagën përtej kufijve të vendit tonë", deklaroi ministrja e Mbrojtjes. Sa i takon trajtimin, sipas saj ka ende shumë për të përmirësuar. "Trajtimi nuk është i krahasueshëm me aleatët e tjerë dhe ndoshta nuk është as ai që do donim ne që të ishte, apo ai që ju meritoni. Por dua t'ju them që jemi maksimalisht të angazhuar edhe unë si ministre, por edhe ne si qeveri që të sjellim një standard të ri në trajtimin tuaj jo vetëm njerëzor, por edhe financiar. Dhe sigurisht një standard të ri në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura për përparimin në karrierë, duke e bërë atë gjithnjë e më meritokratike", u shpreh ministrja e Mbrojtjes.

## "Dëbimi i rusëve, në unison me NATO-n"

### Zëvendësministri i Jashtëm: Komunikimi me partnerët, deri në dëbimin e rusëve

Shqipëria ka vepruar e koordinuar me partnerët e NATO-s dhe Bashkimit Europian në çështjen e dëbimit të diplomatëve rusë, por jo vetëm. Zëvendësministri i Jashtëm, Etjen Xhafaj, rrefeu për "Vizion Plus" edhe komunikimin e ngushtë me vendeve partnere deri në detajimin e dëbimit. Ndërsa, përsa i përket çështjes se negociatave me Greqinë, numri dy i diplomacisë shqiptare konfirmoi praninë e ministrit të Jashtëm, Kotzias, të enjten në Tiranë. Mirëpo Xhafaj në një farë mënyre pranoi se kryeministri Tsipras e ka shtyrë vizitën në Shqipëri, pikërisht prej shtyrjes së negociatave. Zëvendësministri i Jashtëm nuk harroi të theksojë edhe heqjen e vizave në mënyrë të njëanshme nga Shqipëria prej 1 prillit për një numër vendesh si Rusia, Kina, Bjellorusia etj., për të nxitur shtetasit nga këto vende të vijnë si turistë në Shqipëri.

me burg, ndërsa për ministrin e Brendshëm që kontrollonte piramidën e këtij trafiku ka mbrojtje politike nga ana e kryeministrit

Rama. "Dokumenti prej 18 faqesh është bazuar në të dhënat e Antimafies italiane, e cila ka përgjime bisedash dhe shkëmbime me-

sazh mes Habilajve dhe drejtuesve të lartë të Policisë së Vlorës, të cilët provoheshin se ishin garantët për prodhimin dhe trafikun e kanabisit drejt Italisë", theksoi z. Alibeaj. Deputeti demokrat shtoi se, "çdo shqiptar që i dëgjon këto fakte e ka të qartë se nuk janë lidhje rastësore, por janë lidhje që tregojnë se Tahiri ka qenë garancia politike për trafikimin e kanabisit nga banda e Habilajve. Pse për drejtorin e Policisë së Vlorës ka një kërkesë për arrest me burg dhe për Saimir Tahirin jo? Edi Rama po mbrohon Tahirin dhe veten, duke u kthyer në pengesën kryesore për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian", theksoi z. Alibeaj. Për të provuar lidhjet e ish-ministrit me bandën e Habilajve, tashmë ka nisur nga puna edhe komisioni hetimor i kryesuar nga demokratët, ndërkohë në mblidhjen e disa ditëve më parë u ra dakord për planin e hetimit.



**EDI RAMA**

"Nisja e vettingut me goditje ligjore për subjektin e parë që kaloi sitën e këtij procesi historik për drejtësinë shqiptare, e ka dhënë liderin historik të PD-së dhe partinë e tij, por asnjë baltosje e mëtejshme e vettingut nuk ka shans ta frenojë pastrimin e Pallatit të Drejtësisë nga gjykatësit e prokurorët e korruptuar", - u shpreh dje, kryeministri Rama.



Presidenti përshëndet 95-vjetorin e Komunitetit Mysliman

**Ilir Meta: Bashkëjetesa fetare në Shqipëri, shembull për mbarë botën**

Presidenti i Republikës, Ilir Meta vlerësoi dje, tolerancën fetare në vendin tonë. Gjatë fjalës përshëndetëse në 95-vjetorin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, Meta tha se "është një fakt kuptimplot që disa prej themeluesve të tij ishin pikërisht ndër firmetarët kryesorë të Aktit të Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912". "Kontaktet e botës shqiptare me besimet fetare janë shumë shekullore. Përgjatë këtij rrugëtimi shqiptarët myslimanë kanë luajtur një rol vendimtar në të gjitha proceset shtet-formuese që ka kaluar vendi ynë", u shpreh kreu i shtetit. "Regjimi ateist komunist e goditi dhe e ndaloi fenë! Shkatërroi xhami e kisha. Persekutoi klerikë dhe besimtarë, por nuk mundi të mposhte besimin e shqiptarëve të Zotit. Bashkëjetesa, harmonia dhe toleranca midis feve të ndryshme është një karakteristikë e veçantë si për të kaluarin, ashtu edhe për të sotmen e shqiptarëve", nënvizoi Presidenti. Meta tha se "modeli shqiptar i harmonisë dhe mirëkuptimit midis komuniteteve fetare është një pasuri e çmuar për ne shqiptarët dhe një shembull për mbarë botën". Meta ishte dje, i pranishëm edhe në veprimtarinë përkujtoese me rastin e 73-vjetorit të themelimit të shkollës "Skënderbej". Presidenti Meta, duke iu drejtuar të pranishmëve të shumtë, e vlerësoi maksimalisht kontributin e Shkollës së Mesme ushtarake "Skënderbej", duke thënë: "Edhe sot ish-'Skënderbegasit' janë aktivë. Ata drejtojnë Forcat e Armatosura, institucionet e Sigurisë Kombëtare". "Kjo e sotnja është edhe një ditë reflektimi, jo vetëm një ditë vlerësimi, ditë respekti, ditë nostalgjie për t'i kushtuar me shumë vëmendje arsimimit në tërësi, sidomos edukimit të rinjve me ndjenjat atdhetare, kombëtare, patriotike. Janë shumë të rëndësishme sot në kohën kur globalizimi sikur ka mjaft mundësi të mira që ofron për zhvillim, edhe mund t'i cenojë këto vlera në rast se shoqëria nuk tregohet e kujdesshme dhe nuk tregon vëmendjen e duhur ndaj brezit të ri", tha Meta.

10 prokurorët e gjyqtarët që i shpëtuan kontrollit të pasurisë

**KPK ndërpret vettingun edhe për 3 zyrtarë të drejtësisë**

*Gjyqtarja Fana e prokurori Tola dhanë dorëheqjet*

Darina Tanushi

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ndërpreu dje, procesin e vettingut për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë Mirela Fana, e cila është dorëhequr në datë 30 janar 2017 si dhe për prokurorin e Krujës Sulejman Tola, i cili ka dhënë dorëheqjen në datë 26 janar 2017. Ky komision ndërpreu po ashtu kontrollin edhe për Eritan Shehun me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Ai ka dhënë dorëheqjen para një viti dhe për ketë arsye i është ndërprerë vettingu. Sipas ligjit të dorëhequrit dalin jashtë sistemit të drejtësisë për 15 vjet dhe paguhet për 3 vjet. Të dorëhequrit para procesit të vettingut nuk hotohen penalisht. Neni 52 i ligjit të Vettingut thekson në pikën 1 se "subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit". Pika 2 e të njëjtit nen shton se "pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagësi kalimtare sipas ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit". Bashkë me dy zyrtarët e drejtësisë që i shpëtuan vettingut, tashmë lista e atyre që nuk do të kontrollohen ka shkruar në 10 persona, të cilët më parë kanë dhënë dorëheqjet në detyrat përkatëse. Bëhet fjalë për gjyqtarë, prokurorë dhe ndihmës ligjorë të gjykatës së Lartë, të cilët nuk do të kalojnë në filtrin e vettingut, ku mes tyre spikat edhe emri i ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla. Ish-kryeprokurori i vendit deri në dhjetor 2017, u dorëhoq nga sistemi i drejtësisë, duke mos pranuar emërimin si gjyqtar në Apel. Dorëheqja që Adriatik Llalla i paraqiti Presidentit të Republikës dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit disa ditë më parë, i siguroi atij edhe përjashtimin nga procesi i vettingut. Më herët KPK



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

**LISTA E ZYRTARËVE QË U ËSHTË NDËRPRERË VETINGU**

- Ilir Çeliku, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë
- Erlindi Basha, ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë
- Ilir Pashaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan
- Etleva Sherifi, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë
- Adnand Bërdica, ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë
- Mirela Fana, gjyqtare pranë Gjykatës së Lartë
- Sulejman Tola, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë
- Eritan Shehu, ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë
- Adriatik Llalla, ish-Prokuror i Përgjithshëm
- Besnik Imeraj, ish-anëtar i Gjykatës Kushtetuese

**Kreu i Ligjeve: Opozita anatemoi reformën me shumë mllef**

**Manja: Baltosja e opozitës nuk e ndalon vettingun në drejtësi**

Kryetari i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja tha dje, se opozita po hesht për fillimin e zbatimit të vettingut. "Gjatë këtyre ditëve opinioni publik ka pritur që opozita të thotë dy fjalë të procesit të zbatimit të reformës në drejtësi, por më kot. Heshjtja filloi të hënën në Këshillin Kombëtar të Integritimit, ku opozita jo vetëm nuk e përshëndeti fillimin e punës dhe betimin e parë të Komisionit të Kualifikimit, por me shumë mllef politik e anatemoi reformën në drejtësi në përpjekjen e dështuar të radhës duke ngjallur panik për bllokimin e institucioneve të drejtësisë", tha ai. Më tej, Manja pohoi se në drejtësi faktet e njohura botërisht nuk mund të hidhen poshtë dhe



KUVENDI I SHQIPËRIE

ishite po kjo opozitë që e bllokoi reformën në drejtësi për gati një vit me ankimin e ligjit të vettingut në Gjykatën Kushtetuese dhe me 'çadrën' e Republikës së Re. "Por vëri i opozitës ndaj vettingut dhe reformës në drejtësi mbeti në gojë e mbyllur të Luzlim Bashës dhe Sali Berishës, të cilët në vend që të përshëndesin fillimin e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zgjodhën hesh-

tjen, apo më keq akoma, Sali Berisha lideri historik i Partisë Demokratike nxitoi të bëjë avokatinë e palës që humbi me përballjen e KPK në një proces të rregullt kushtetues dhe ligjor në prani e vëzhguesve ndërkombëtarë", tha ai. Po ashtu, Manja theksoi se "asnjë baltosje e mëtejshme e vettingut nuk ka shans ta frenojë pastrimin e pallatit të drejtësisë nga gjykatësit dhe prokurorët e korruptuar. Sot gojë e liga kundër vettingut duhet të heshtin përgjithmonë dhe ta lënë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, Komisionerin Publik, Vëzhguesit Ndërkombëtarë të ONM-së dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit të bëjnë detyrën që u ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji".

ka ndërprerë procesin e vettingut edhe për ish-anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, Besnik Imeraj. Pak ditë më parë KPK mori dhe vendimin e parë për shkarkimin e gjyqtarit kushtetues Fatos Lulaj nga detyra me argumentin se

ky i fundit nuk justifikonte pasurinë. Ka e qenë e njëjta trupë gjykuese e komisionit e përbërë nga Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Xhensila Pine që ka vendosur ndërprerjen e rivlerësimit për ta. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi të ndërpresë procesin e vettingut për Ilir Çelikun, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit të Vlorës. Ilir Çeliku përjashtohet nga vetingu pasi ka dhënë dorëheqjen përpara nisjes së këtij procesi.

## RIORGANIZIMI FORUMET

Ndryshimet në statut, Basha do të mbledhë forumin më të lartë vendimmarrës

# Berisha: Para Kuvendit do të mbledhet këshilli kombëtar

Shehu: Analiza e humbjes vazhdon në nivelin e kongresit

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, pritet të mbledhë këshillin kombëtar para mbledhjes së kuvendit, i cili më 28-29 prill dhe do të diskutohen ndryshimet në statutin e partisë. I pari që e njoftoi mbledhjen e këtij forumi ishte vetë ish-lideri i demokratëve, Sali Berisha. "Do bëhet mbledhja e këshillit kombëtar. Para kuvendit do ketë mbledhje të këshillit kombëtar. Mbledhja e këshillit kombëtar do të diskutojë ndryshimet statutore... Shpresoj se do e thërrasë, sepse realisht nuk e di. Mbledhja e këshillit kombëtar do të diskutojë ndryshimet e statutit që do t'i miratojë këshilli kombëtar. Më pas këto do t'i kalojnë Kuvendit kombëtar. Forma më e mirë e miratimit të tyre. Ndonëse në djetën time, ndryshimet statutore mund të miratohen vetëm në këshillin kombëtar dhe të kalohen në kuvend, por mënyra më e mirë dhe më serioze është të miratohen në kuvend", deklaroi z.Berisha në "Fax News". Kurse deputeti Tritan Shehu shpreh bindjen se: "Së pari, PD do shkojë në një kongres të saj për të vazhduar analizën në nivelin e kongresit. Së dyti, me ndryshime statutore që janë të rëndësishme, që janë deklaruar. Kryetari Basha e deklaroi axhendën e kongresit për të krijuar premisat akoma më të hapura të demokracisë, për të vazhduar bashkë ristrukturimin e partisë dhe për t'u bërë gati për zgjedhjet që mund të jenë shumë shpejt". Në mbledhjen e fundit të kryesisë, kundërshtarët e Bashës në PD kërkuan thirrjen e këshillit kombëtar, tezë e cila u kundërshtua nga Basha, i cili njoftoi se kuvendi kombëtar i PD do zhvillohej gjatë muajit prill. Por duket se Basha ka ndryshuar lëvizje dhe ka pranuar propozimin e anëtarit të kryesisë, ish-ministrit të Mbrojtjes, Arben Imami. Për mbledhjen e këshillit kombëtar nuk ka ende një



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

### KRITIKET

Në funksion të ringritjes së PD, kritikët e Lulzim Bashës prej disa muajsh kanë paraqitur propozime konkrete, mes të cilave kërkojnë edhe dorëheqjen e tij nga posti i kreut të partisë. Këto propozime, së bashku me ato të mbërritura nga baza demokrate do të jenë pjesë e ndryshimeve statutore, të cilat do të miratohen në kuvendin kombëtar.



### PROPOZIMET

Nga baza i kërkohej kreut të PD-së që zgjedhja e kandidatëve për deputetë dhe kryetarë bashkie të bëhet nga anëtarësia dhe emrat e tyre të paraqiten 60 ditë përpara zgjedhjeve. Mes propozimeve është edhe një tjetër sugjerim, që kërkon zgjedhjen e krerëve të degëve përmes parimit "një anëtar, një votë", ndërsa për sekretarët sugjerohet zgjedhja nga kuvendi kombëtar.

## Patozi ironizon 'demokratët': Më shumë ata në krah të Veliajt se sa anëtarët e PS

Ish-deputeti demokrat, Astrit Patozi ironizoi dje sërisht kreun aktual të kësaj force politike, Lulzim Basha. Në një postim në rrjetin social "Facebook", ai publikoi foton e një anëtari të Partisë Demokratike, i cili është shfaqur për krahe kryebashkiakut Veliajt duke mbjellë pemë para disa ditësh. Patozi shkruan se më shumë ka parë anëtarë të këshillit kombëtar të Partisë Demokratike për krahe Veliajt këto kohë sesa anëtarë nga Komiteti drejtues i PS-së. Një lajm i mirë nga kongresi i Lulit. Më mori në telefon një demokrat i entuziazmuar dhe më tha se 'e dëgjoi Luli këshillën e Doktorit,



do ta mbledhë këshillin kombëtar përpara kongresit'. Dakord mo - i thashë - lajm i mirë qenka, por më rezultoi se janë më shumë anëtarë të këshillit kombëtar të Par-

tisë Demokratike, se sa anëtarë të komitetit drejtues të PS, ata që kanë dalë në televizor këto ditë duke mbjellë pemë me Lali Erin".

datë, por mësohet se në këtë forum do të diskutohet paraprakisht dokumenti me propozimet e përmbledhura për ndryshimet në statut. Në këtë këshill pritet të ketë propozime të reja, të mund të adoptohen në statutin e ri të PD. Një nga pikat ku insiston grupi kritik ndaj Bashës, është ajo e analizës së humbjes së 25 qershorit dhe procesi i rizgjedhjes së Bashës në krye të PD në korrik përballë Selamit. Kritikët, të cilët në 25 qershor i

la jashtë listave për deputetë, Lulzim Basha i ftoi sërisht ditët e fundit t'i bashkohen PD-së. "I kam ftuar publikisht, individualisht në të gjitha format e mënyrat dhe festa është e sigurtë. Jam e bindur që PD do shkojë përmes bashkimit drejt një përgatitjeje për përballje vendimtare me të keqen që sundon sot vendin", tha z.Basha. Pas humbjes në zgjedhje dhe ringritjes në karrigen e kreut të PD-së, kritikët e

akuzuan për personalizim të partisë, shkelje të statutit dhe asgjësim të mendimit ndryshe. Por përpara studentëve të Shkencave Politike, Lulzim Basha tri ditë më parë foli për hapje të partisë dhe një reformim të brendshëm të saj, duke nisur nga përzgjedhja e kandidatëve për deputetë. "Keni ardhur në një moment të veçantë për PD, po përgatitemi të bëjmë ndryshime në parti, transformim", theksoi z.Basha.



Bernd Borchardt

## OSBE, Borchardt: Votimi elektronik, i ndërlikuar

Futja e numërimit elektronik në zgjedhjet e ardhshme, një kërkesë e mundshme dhe e pranueshme nga të dyja palët politike në vend, merr edhe mbështjen e kreut të prezencës së OSBE në Tiranë, ambasadorit Bernd Borchardt. Por ambasadori, Borchardt flet për TV "Klan" me rezervë për votimin elektronik. "Votimi elektronik është një çështje pak më e ndërlikuar. Pikë së pari, që të bëhet votimi elektronik duhet që vendimi të merret sa më shpejt, pasi një nga rekomandimet tona të hershme është që teknologjia të testohet dhe zgjedhjet e ardhshme janë pak më shumë se një vit larg. Para kësaj, duhen bërë studimi i fizibilitetit, procese prokurimi, duhen trajnuar zgjedhësit, duhen trajnuar njerëzit në qendrat e votimit, duhet të bëhen teste, duhen kalibruar pajisjet. Të gjitha këto janë diçka e re, kështu që kërkojnë kohë. Edhe nëse testi më të mirë, le të themi, vetëm në dy bashki. Dihet përparësitë e votimit elektronik dhe veçanërisht të identifikimit elektronik të zgjedhësve, por sigurisht bëhet fjalë për teknologji dhe teknologji edhe mund të dështojë. Prandaj, duhet të ekzistojë garancia që kjo teknologji nuk do të dështojë ditën e votimit. Kjo është më kryesorja. Aspektë të tjera që duhen pasur parasysh janë kostot financiare dhe fakti që teknologjia nuk zgjidh të gjitha problemet dhe akuzat e ngritura në kontekstin e dyshimeve për manipulim votash. Përveç kësaj, krijohen mundësi për akuzat të tjera: për manipulim të programeve kompjuterike, sulme kibernetike, e të tjera. Për të gjitha këto arsye, kjo është një çështje që duhet diskutuar në mënyrë të hollësishme dhe vendimet duhen marrë sa më shpejt", tha ambasadori i OSBE .



150 kamionë nga Kosova kaluan kufirin mëngjesin e kësaj të mërkure në Morinë. Protestës i janë bashkuar dhjetëra tregtarë, të cilët në shenjë proteste parkuan kamionët në të dy anët e doganës, duke krijuar një varg prej disa kilometrash. Kamionistët përshkuan autostradën "Ibrahim Rugova" në Kosovë e më pas hynë në "Rrugën e Kombit", pa pasur asnjë ngarkesë për të sjellë. Ata mbanin parulla me të cilat kundërshtonin vendosjen e një pagese për kalimin në pjesën e "Rrugës së Kombit" në Shqipëri. Në pankarta shkruhej edhe një thënie e Faik Konicës "Ruje Zot Shqipërinë nga shqiptarët", dhe "Ne po

Parullat e kamionistëve: "Ne po vendosim kufi, nuk po e heqim"

150 kamionë nga Kosova protestojnë në Shqipëri kundër taksës së rrugës



Një prej kamioneve të protestës në Morinë

istojë kjo taksë", -tha njëri prej tyre. Në protestë morën pjesë importues të kripës, hekurit e prodhimeve të tjera shqiptare. Ata mbanin në duar edhe pankarta, ku ironizonin vendimet e dy qeverive për forcimin e bashkëpunimit ekonomik. Ata madje kanë paralizuar ndërprerjen e shkëmbimeve tregtare me Shqipërinë për shkak të taksës në "Rrugën e Kombit". Autokolona e kamionëve, pas marshimit është kthyer sërish në Kosovë, ndërsa pritet për t'u parë se sa kjo taksë do të ndikojë në shkëmbimet tregtare mes dy vendeve.

vendosim kufi, nuk po e heqim atë". 22 euro duhet të paguajnë ata për çdo lëvizje, 44 në total në dy kalimet. Kamionistët thanë se kjo tak-

së do t'i dëmtojë, duke u rritur kostot e transportit. "Kjo taksë është e papërbalueshme për bizneset tona. Nuk ka vend rajoni që të ezk-

Shoferët do të paguajnë 5 euro për një kalim me autoveturë dhe 22.5 euro për kamionët e tonazhit të rëndë

# Nis pagesa për kalimin në "Rrugën e Kombit"

## Balla: Argumentet për mirëmbajtjen e autostradës Durrës-Kukës

Darina Tanushi

Pagesa e taksës për të kaluar në "Rrugën e Kombit" ka filluar të aplikohet qysh dje. Tashmë çdo qytetar që do të kalojë aty me autoveturë do të paguajë 5 euro për një kalim, ndërsa një kamionist do të paguajë 22.5 euro vetëm për një rrugë. Kompania koncesionare nisi aplikimin e pagesës për mjetet sipas tarifave të përcaktuara, edhe pse u tha se kjo do të niste aplikimin në mes të muajit prill. Taksa e qarkullimit në "Rrugën e Kombit" u vendos pas dhënies me koncesion të mirëmbajtjes dhe përfundimit të saj. Vendimi i qeverisë shqiptare është kundërshtuar nga banorët e Kukësit si dhe komuniteti i biznesit në Shqipëri dhe Kosovë. Pritet që më 31 mars, edhe banorët të Kukësit të bëjnë një protestë në tunelin e Kalimashit, kundër kësaj takse. Por, nga ana tjetër, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla publikoi dje, disa fakte dhe argumente lidhur me mirëmbajtjen dhe operimin në autostradën Durrës-Kukës. Duke e cilësuar shterpë debatin e krijuar se fundmi, Balla deklaroi se "ndonëse rruga Durrës-Kukës quhet autostradë, në fakt, ajo nuk u përfundua kurrë. Në segmentin e parë Milot-Rrëshen, mbetet i parealizuar njëri krah, 25.6 km i



"Rruga e Kombit"

TARIFAT PËR TË KALUAR NË RRUGËN E KOMBIT

- Klasa 1 motor - 2.5 euro
- Klasa 2 veture - 5 euro
- Klasa 3 autobus & kamionçinë - 11.2 euro
- Klasa 4 kamion i mesëm - 16.2 euro
- Klasa 5 kamion i rëndë - 22.5 euro

rrugës. Në segmentin e dytë prej 61 km mungojnë masa gjeoteknike mbrojtëse skarpatesh dhe eliminimi i rrëshqitjeve. Në segmentin e tretë Kalimash-Morinë nuk janë përfunduar viaduktet dhe urat. Vlerësohet se për përfundimin e plotë të rrugës do të duheshin rreth 200 milionë euro të tjera. Duke mos llogaritur këtu dëmin që rruga ka pësuar gjatë gjithë këtyre

viteve të operimit ku është kryer vetëm mirëmbajtje rutinore". Ai vë në dukje se "vlerësohet se kostoja e mirëmbajtjes rutinë, dimërore, e tunelit, menaxhimi, e operimit të rrugës, tunelit dhe tollit të arrijë në rreth 5.3 milionë euro në vit". Ndërsa se si erdhni opsioni i koncesionit për Rrugën e Kombit, Balla sqaron se "ish-kryeministri Sali Berisha miratoi me

VKM Nr.874, datë 14/12/2011 "Përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënie me koncesion të shërbimit të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe operimit të autostradës Milot-Morinë". Në datën 19/12/2011, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit publikoi ftesën për pjesëmarrje në procedurën parakualifikuese të koncesionit. Në datën 02/04/2012, publikohet në APP njoftimi për rezultatet e fazës parakualifikuese ku marrin pjesë pesë kompani. Kjo përpjekje e Partisë Demokratike dështoi pasi nuk pati sukses faza e dytë në prill 2013, kur nuk erdhni asnjë ofertë". Në dhjetor 2014 me urdhrin nr.336, datë 31.12.2014 të ish-ministrit të Transportit dhe Infrastrukturrës Edmond Haxhinasto u miratua Studimi i Fizibilitetit. Me urdhrin nr.337, datë 31.12.2014 të ish-ministrit Haxhinasto u miratua fillimi i procedurave për dhënie me koncesion/PPP të ndërimit, operimit, mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të autostradës Milot-Morinë. Në 6 dhjetor 2016 u nënshkrua kontrata nga ministri Sokol Derwishaj dhe koncesionari "Catalyst Viva Das General Contracting" LLC, "Salillari" shpk, "Violiap Ateve", "Bee Tech", "Kastrati" sh.a. Në 14 dhjetor 2016 marrëveshja u miratua në qeveri. Kontrata e koncesionit është bërë efektive në 9 shtator 2017, përfundon Balla.

REAGIMI

Ambasadori i Kosovës, Ukshini: Tarifa e rrugës e lartë, Shqipëria ta rishikojë

Ambasadori i Kosovës në Tiranë, Sylë Ukshini e vlerësoi dje, të lartë tarifën e vendosur nga pala shqiptare për kalimin e automjeteve në Rrugën e Kombit. Ukshini i bëri thirrje qeverisë shqiptare ta rishikojë këtë tarifë. Në një intervistë për Report TV, Ukshini tha dje se Kosova s'kishte dijeni për nivelin e tarifës dhe se ai është takuar me ministrin Gjoknuri për këtë çështje. Sipas tij, taksa mund të jetë e nevojshme, por jo në këtë nivel, pasi dëmtohen qytetarët e Kosovës dhe do të ulen vizitorët. "Qeveria shqiptare është dashur të njoftojë ambasadën dhe qeverinë e Kosovës që njerëzit të dinë detajet e këtij vendimi. Autoritet shqiptare janë sovranë dhe mund të marrin një vendim të tillë, por duhej një njoftim dhe harmonizim paraprak. Ministri kosovar i infrastrukturës Pal Jaku ka kërkuar në mënyrë urgjente një takim me z. Gjoknuri për të gjetur modalitete të tjera për aplikimin e kësaj takse", sqaroi ambasadori i Kosovës. Ai shprehet për "uljen e tarifës dhe gjetjen e metodave më të mira të aplikimit". "Njerëzit, kompanitë e bizneseve që kanë një qarkullim ditor, duhet gjetur një taksë mujore ose vjetore që të jetë më e leverdishme. Nëse ngelet kjo tarifë kaq e lartë, kostoja është e papërbalueshme. Ne e dimë se nga Rrësheni në Milot rruga është e pa përfunduar. Sikur rruga të ishte e kompletuar dhe standarde dhe mund të justifikohet. Unë pata një takim me ministrin Gjoknuri dhe mora informacion se mirëmbajtja e rrugës është me kosto të lartë. Dy ministrat tanë duhet ta diskutojnë, Gjoknuri më shprehu gatishmërinë për takim produktiv për ta diskutuar", -tha ambasadori i Kosovës. Ai sqaroi se Kosova e mirëmban pjesën e rrugës së saj me fondet publike dhe nuk ka vendosur tarifë.



Gubernatori Gent Sejko

### Luhatjet e kursit të këmbimit

## Sejko: Banka e Shqipërisë nuk është përfshirë

Gubernatori Gent Sejko mohoi dje që Banka e Shqipërisë të ketë pasur ndonjë ndikim në lëvizjet e kursit të këmbimit valutor në javët e fundit. Ai theksoi edhe njëherë se Banka Qendrore beson në regjimin e lirë të kursit të këmbimit. Banka e Shqipërisë mund të ndërhyjë vetëm në

raste luhatjesh të mëdha të kursit, por sipas Guvernatorit, nuk janë verifikuar kushte të tilla që do të kërkonin ndërhyrjen e autoritetit monetar në vend. Në analizën për ecurinë e ekonomisë shqiptare, Banka e Shqipërisë konkludon sërish se ekonomia është ende nën potencialet e veta të rritjes,

ndërsa afrimi me objektivin e inflacionit po frenohet nga rritja e dobët e çmimeve të importuara dhe nga forcimi i lekut në kursin e këmbimit. Megjithatë, ai tha se tendenca e përmirësimit të rritjes ekonomike ka vazhduar edhe gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Sejko theksoi se nor-

mat e ulëta të interesit po mbështesin rritjen e huadhënies dhe të konsumit në ekonomi. Sipas tij, në dy muajt e parë të këtij viti kredia u rrit mesatarisht me 5.8%. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në nivelin 1.25%. Guvernatori Sejko tha se inflacioni për këtë vit do të jetë pranë nivelit 2.2%, ndërsa kthimi pranë objektivit 3% parashikohet të ndodhë brenda vitit të ardhshëm.

S'ka nevojë për vërtetim, 1 vit burg do t'iu njihet si dy vite punë

Ornela Manjani

# Zbardhet VKM, ndryshon ligji për dëmshpërblimet e ish-të përndjekurve

## Përfitojnë 264 ish-të dënuar politikë të regjimit komunist

Të gjithë ish-të dënuarve që kanë vuajtur dënimin në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë, vitet e qëndrimit do t'u njihen si punë e kryer në minierë. Qeveria ka propozuar një ndryshim në ligjin për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, ku për efekt pensioni koha e vuajtjes së dënimit do të konsiderohet punë e paguar. Periudha që do të njihet do të jetë sa dyfishi i kohës së qëndrimit në këto burgje. Pra, nëse një ish-i dënuar ka qëndruar 10 vjet në burgun e Spaçit apo Qafë Barit, atij do t'i njihen 20 vite pune në minierë. Paga do të llogaritet e njëjtë me pagën e punës në minierë. Për të marrë vërtetimin për kohën e vuajtjes së dënimin në burgjet ku punohej në minierë, individët që preken nga ky projektligj, pas votimit në Kuvend, mund t'i drejtohen Ministrisë së Brendshme. Ndryshimet në Ligj zgjidhin një numër konfliktesh mes ish-të përndjekurve dhe shtetit shqiptar. Këta të fundit nuk përfitonin dot pensionin, pasi institucionet nuk gjenin dot dokumentet që vërtetojnë se kanë punuar në nëntokë. Me ligjin e vitit 2014 për minatorët, parashikohet se kush ka punuar në nëntokë për mbi 12 vite përfiton pension të plotë. Me

këtë ndryshim, një individ që ka vuajtur të paktën 6 vite në burgjet e mësipërme do të mund të përfitojë, gjithashtu, pension të plotë.

### VKM-JA

Vendimi i Këshillit të Ministrave saktëson se "Koha e vuajtjes së dënimin të ish-të dënuarve politikë në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë, për efekt pensioni, të njihet si punë e kryer në minierë në nëntokë. Periudha njihet sa dyfishi i periudhës së qëndrimit në këto burgje. Paga llogaritet sa paga e punës në minierë. Vërtetimi për kohën e vuajtjes së dënimin të burgjet ku punohej në minierë në nëntokë lëshohet nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë." Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ka bërë ditur në muajin shkurt iniciativën e qeverisë për ndryshimin e ligjit. Ministri Arben Ahmetaj zhvilloi në atë



kohë një interpelancë me një grup ish-të përndjekurish ku bëri të ditur se të gjithë ish-të përndjekurit politikë, që në kohën e burgimit kanë punuar në minierë do të trajtohen me ligjin e minatorit.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj gjatë një interpelance me ish-të përndjekur në Platformën e Bashkëqeverisjes me Njerëzit, deklaroi se ligji do të thjeshtohet. Kështu

ish-të përndjekurit nuk kanë nevojë të kenë vërtetim që kanë qenë në burg, por automatikisht nga ISSH do iu njihen një vit burg barsa me dy vite punë. "Pasi ka ardhur ankesa jua, ne kemi

pasur një takim të detajuar me kryeministrin. Arsyeya e vonesës është se, sipas Ligjit 7514 "Për trajtimin e minatorit", ju kërkon ju që të merrni një dokumentacion në një komisioni të ngritur nga ministria e Drejtësisë dhe e Brendshme. Kryeministri e konsideron si një procedurë të lodhshme për ju. Kështu kryeministri më kërkoi mua të bëjë disa ndryshime në ligj, i cili do kalojë pas një muaji në parlament. Pra, me këtë thjeshtim të ligjit ju nuk keni nevojë për dokumentin e vërtetimit, në mënyrë automatike një vit burg do t'ju llogaritet si dy vite punë. Ju jeni 264 persona që përfitonin nga ky ndryshim ligji, i cili do thjeshtohet". Një tjetër problematikë e ngritur nga ish-të përndjekurit, ishte dhe vonesa e pagesës për dosjet, si dhe dëmshpërblimi nga ligji i terrorit në burgje, për të cilat ministri pretmoi se do marrin zgjidhje.

### Deklarata e Tatim Fitimit dhe pasqyrat financiare

#### DPT: 30 mars, afati i fundit

Të gjithë tatimpaguesit duhet të bëjnë pagesën e deklaratës së Tatim Fitimit për vitin fiskal 2017 brenda datës 30 mars 2018. Përmes një njoftimi në faqen zyrtare të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u kujton tatimpaguesve që brenda këtij afati për dorëzimin e deklaratës së pagesës, duhet të dorëzojnë, gjithashtu, edhe pasqyrat financiare për vitin e kaluar. Sipas administratës tatimore, duhet që pasqyrat financiare të dorëzohen të sakta. Ndërkohë, pas përfundimit të këtij procesi, do të bëhet verifikimi i pasqyrave financiare për tatimpaguesit, të cilët rezultojnë me ulje të Tatim Fitimit dhe me deklarata zero.



### Vendimi i Këshillit të Ministrave

## Taksa e pasurisë, krijohet drejtoria e posaçme



Këshilli i Ministrave vendosi për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë. Ky institucion do të jetë në varësi të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj dhe do të ketë si mision administrimin në nivel qendror taksën vendore mbi pasuritë e paluajtshme. Ndryshimi i formulës për taksën e pronës apo biznesit e ka bërë më të komplikuar edhe metodologjinë mbi të cilën do të llogaritet shuma që duhet të paguajë çdo individ apo sipërmarrës. Detyra kryesor e kësaj drejtorie duket se do të jetë menaxhimi i regjistrat qen-

dror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme, apo i njohur si kadastra fiskale. Drejtoria do të funksionojë, gjithashtu, si monitorues dhe asistues i bashkive në procedurat që ndjekin për llogaritjen e kësaj takse. Institucioni do të asistojë edhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes njësive të vetëqeverisjes vendore dhe agjentit të autorizuar për mbledhjen e taksës së ndërtesës, apo institucioneve të tjera informuese.

Abuzimet me pronat në bregdet, cilat janë 10 zonat më problematike

# Artan Lame: Në verifikim 30 mijë parcela, ja kush "digjet"

## Ja 4 rrugët më të përdorura për paligjshmëri

Ornela Manjani

Kryetari i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, ALUIZNI, Artan Lame, deklaroi se i gjithë bregdeti i jugut është i paregjistruar. Në një bashkëbisedim me gazetarët, Lame tha se, "në këto 27 vite i gjithë bregdeti i jugut nuk është regjistruar qëllimisht, në mënyrë që të 'shqyhet' se hajdutëria s'ka parti, pasi blu e kuq kanë abuzuar". Sipas tij, ligji për pronat degradoi pas vitit 2000, ku u nda toka që ishte për t'u ndarë dhe mbeti pjesa tjetër. "Ligji për pronat degradoi dhe u kthye në një proces degradues pas vitit 2000, sepse u nda toka që ishte për t'u ndarë dhe mbeti toka që nuk ishte për t'u ndarë. I gjithë bregdeti i jugut është i paregjistruar. Zona e Velipojës, bregdeti i Lezhës, Gjiri i Lalëzit, zona e Kavajës janë zona të pahedhura në sistemin e hipotekave. Një pjesë e madhe e vijës bregdetare po ashtu rezultoi e paregjistruar. Janë bërë abuzime me Ligjin 7501, zonat janë ndarë si toka bujqësore, kur ajo janë toka bregdetare", theksoi Lame. Por, Vlorë nuk është garku i vetëm që do të kalojë në sitë. Task Forca do të verifikojë mbi 30 mijë parcela në të gjithë vijën bregdetare të vendit. Qeveria ka pezulluar tërësisht regjistrimin e pronave bregdetare në hipotekë dhe po përgatit ndryshimet ligjore për të cilave do të shtetë tokën e marrë abuzivisht. "Nëpërmjet prefektëve dhe nëpërmjet Task Forces së ngritur të bëjnë verifikimin e atyre që s'janë regjistruar ende. Ndërsa tek ato të regjistruara të shohim se sa këta persona kanë qenë banorë të fshatit në vitin 1991, sesa u takonte të merrnin tokë dhe se sa ka qenë tokë bujqësore në atë kohë", shprehet kreu i ALUIZNI-t.



Kryetari i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, ALUIZNI, Artan Lame

zonat më problematike, ku sipas të parit të ALUIZNI-t, ato janë Velipoja, Shëngjini, Ishulli Lezhës, Gjiri i Lalëzit, zona e Kavajës, bregdeti i Semanit, i Nartës, Orikumi dhe i gjithë bregdeti i jugut. "Nuk po hyj

në hollësitat se kush e mban përgjegjësinë. Përgjegjësinë e ka njësia administrative që e ka bërë. Përgjithësisht në rang republikë pa bërë ndarje PD dhe PS, i kuq apo i blu, sepse hajdutëria nuk ka

**10 ZONAT MË PROBLEMATIKE**

- Bregdeti i Velipojës
- Bregdeti i Shëngjinit
- Zona e Kune-Vainit
- Ishull Lezhë
- Gjiri i Lalëzit
- Bregdeti i Spillesë në zonën e Kavajës
- Bregdeti i Semanit
- Zona e Nartës
- Zona e Orikumit
- Bregdeti i rivierës, në përgjithësi në jug

ngjyrë. Aty ku janë përzier njësoj administratat vendore me këtë proces dhe asnjëherë nuk e kanë denoncuar dhe nuk kanë krijuar një filter frenimi ndaj procesit", - u shpreh Lame.

**ZONAT MË PROBLEMATIKE:**

Bregdeti i Velipojës, ai i Lezhës, i Shëngjinit, zona e Kune-Vainit, Ishull-Lezha, Gjiri i Lalëzit, bregdeti i Spillesë në zonën e Kavajës, bregdeti i Semanit, zona e Nartës, zona e Orikumit dhe bregdeti i rivierës në përgjithësi në jug.

**Rrugët e përdorura për paligjshmëri:**

- Pajisja me AMTP e të gjithë anëtarëve të familjes veç e veç.
- Pajisja me AMTP e personave apo familjeve që nuk kanë qenë në fshat në vitin 1991.
- Ndryshimi i zërit kadastral të tokës, në tokë bujqësore pa qenë e tillë.
- Lëshimi i AMTP-ve nga komisionet vendore edhe pas vitit 2008, kur nuk mund të jepeshin më prej tyre.

**TIPOLOGJI:**

Në zonën e Shkodrës, kryesisht në Velipojë janë vërejtur regjistrime të AMTP-ve, të cilat janë dhënë për subjekte, të cilat nuk kanë qenë objekt i trajtimit me tokë bujqësore sipas ligjit 7501. Janë evidentuar raste kur qdo anëtar i familjes është trajtuar me AMTP të veçantë dhe këto AMTP janë regjistruar pranë ZVRPP. Institucionet përgjegjëse në këtë rast janë Njësia Administrative, e cila ka dërguar dokumentacionin për regjistrim dhe Zyra Vendore e Regjistrimit, e cila nuk ka kryer konfirmimet dhe hetimet administrative përkatëse, por është mjaftuar vetëm me regjistrim.

Mundësia e kryerjes së veprimeve korruptive është e lartë për sa kohë njësia administrative u është dhënë e drejta për konfirmimet dhe saktësimet e AMTP sipas V.K.M nr.994, datë 15.12.2015.

Në ZVRPP Lezhë është evidentuar fenomeni, i cili është bërë dhe publik, i ndryshimit të zërit kadastral, duke kthyer tokat ranore në tokë bujqësore dhe duke përcjellë për regjistrim AMTP të lëshuara nga Komisioni i Ndarjes së Tokës në Fshat.

Veprime që janë kryer në bashkëpunim me njësiti vendore, Këshillin e Qarkut dhe Zyrën e Regjistrimit.

Në zonën e Vlorës janë vërejtur raste të AMTP të lëshuara në vitin 2008, periudhë kur nuk kanë funksionuar Komisionet e Ndarjes së Tokës në Komunë, pasi kanë qenë të shfuqizuara me ligjin për verifikimin e titujve të pronësisë. Kryesisht rastet e shkeljeve janë konstatuar me këto AMTP, pra të lëshuara mbas vitit 2008.

Veçanta e Vlorës është edhe me regjistrimet e veçanta 1. Janë kryer regjistrime të veçanta të pasurive të përfutura me AMTP pa zbatuar procedurën e duhur ligjore.

2. Kryesisht regjistrimet e veçanta kryhen për zonat në të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, (Palasë, Himarë, Dhërmi, Gjilek, Vuno), ku përmendim që vetëm për periudhën 2013-2017 janë kryer rreth 450 regjistrime të veçanta.

3. Këto kanë sjellë problematika shumë të forta, pasi nuk mund të evidentohet saktë pozicionin i pronës dhe kufitarët e pasurive. Fenomeni është problematik, pasi do të krijohet mbivendosje pronesh në momentin e kryerjes së regjistrimit fillestar sistematik të zonave.

**PYETJE & PËRGJIGJE**

**Pse u vendos verifikimi i AMTP-ve vetëm në zonat bregdetare?**

Në vitin 2008 u bë një ligj për verifikimin e të gjitha AMTP-ve të lëshuara. Fokusi është në bregdet, sepse në Tropojë e Kolonjë nuk ka interes. Këtu ku ka interes vijnë. Problemi është ndjerë që atëherë. Ligji i atëhershëm thoshte të vlerësoheshin 450 mijë AMTP të lëshuara nga janë hapur 25 mijë praktika.

**Pse tani?**

Gjithmonë do ketë një moment pse tani? Me gjithë vullnetin pozitiv pas vitit 2013 për t'i bërë këto institucione të punonin bashkë, vetëm tani ia dolëm që këto institucione të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të bëhen një institucion. Me gëzim duhet të themi se do të merret edhe Këshilli i Europës me reformën e tokës, e kuptuar si elementi thelbësor për zhvillimin e vendit. Sepse çdo gjë që do të bësh, do ta bësh në një tokë, po në rast se aty të dalin 4 pronarë me letra dhe tre pa letra?! Të mos harrojmë rastin e tij që rrahën në rrugë dhe do investonte në Lalëz, gjyqtarë të vrarë etj. Ky moment është i vonuar, por i domosdoshëm. Duam apo s'duam, duhet të jetojmë në Shqipërinë që kemi, Shqipëria ideale ka vdekur nga viti 1991, do të thotë kur shembën sistemin dhe në ëndrrat tona mendonim se do të kishim një sistem ideal. Pas '91-shit e kuptuam që s'e ndërtojmë dot gjë, gjithnjë e më shumë e kuptojmë se s'e bëjmë dot. Procesi i legalizimeve nuk është një proces i ligjshëm, ishte i paligjshëm sepse kishte njëzë që kishin zënë tokën e tjetrit, tokën e shtetit dhe në tokën e tyre kishin ndërtuar pa leje. Kur procesi u bë shumë i madh, u tha ta rregullojmë me sa më pak dhimbje, duke gjetur një të mesme të pranueshme për të gjitha palët. I njëjti proces do ndiqet edhe këtu, do rregullojmë sa të jetë e mundur, sa të jetë e mundur kthimi dhe do prodhojmë qindra procese gjyqësore dhe është e mira të gjejmë forma ligjore se si do t'i bëjmë këto letra fare pa vlerë. Një pjesë e punës i mbetet edhe legjislacionit të ri. Verifikimi tashmë ka nisur. Është ngritur një Taks Forcë dhe njëkohësisht janë ngarkuar gjithë prefektët e zonës bregdetare për zonat e tyre të kompetencës. Pjesa që bëmë në është që ndamë cila është zonë bregdetare dhe s'ka qenë kurrë tokë bujqësore për ta lënë të qetë fshatarin që ka marrë tokën e vet.

**Si do të veprohë me tokat e Alket Hysenajt?**

Ato janë brenda vijës.

**Cili është qëllimi i "aksionit"?**

"Ndaj them që nuk mund t'i shkojmë sot në fund procesit, sepse ka

një mijë mënyra. Një nga opsionet që po diskutojmë është të i vazhdo investimin, do merremi ne si shtet t'i marrim paratë. Qëllimi nuk është të shohim kush ka ndërtuar në bregdet dhe të shkatërrojmë investimet. Qëllimi është t'i marrim tokën atij që nuk i takon dhe t'ia japim atij që i takon. Janë 3 mundësitë: shtetit, investitorit ose ish-pronarit. Sepse kemi edhe të gjithë procesin e ish-pronarëve në bregdet dhe e dimë shumë mirë se si janë bërë kthimet e pronave, veçanërisht në zonën bregdetare. Në themel hipoteka në një vend si Shqipëria duhet ta kishte tagrin gati gjyqësor. Që do të thotë se kur të vjen letra, ti duhet të jesh barriera e fundit që më përgjegjshëri të vendosësh nëse ky dokument është i ligjshëm ose jo. Diku nga vitet 2000 ky tagër që e kishte hipoteka u hoq me ligj, me ligjin që dokumentin e pronësisë së prodhon hipoteka, kështu që s'mund t'ia heqësh ti. Pjesë e ndryshimeve është dhe kjo gjë, për ta fuqizuar si institucion me shpresën dhe lutjen te Zoti që ky institucion do mbetet i përgjegjshëm në vendimmarrjen për të mos u kthyer në gjenues problemesh e sherresh të tjera. A ka burime njerëzore për të zbardhur intensitetin e vjedhjes së çdo prone? Aftësia e shqiptarëve për të prodhuar paligjshmëri është shumë më e vogël se aftësia e shtetit për t'i vajtur pas e për t'i rregulluar. Ne kemi bërë thirrje disa herë për punësim, por unë jam kufizuar në degën e inxhinierive, kategori që dinë të bëjnë matje që ditën e parë në terren. Do arrijmë të shtettrrethimi juridik i terrenit. Besoj se legjislacioni i agjencisë së re të pronave që do miratohet brenda gjysmës së parë të këtij viti dhe që hyn në fuqi vitin tjetër, do ta mbyllë këtë çështje nga pikëpamja formale. Organet e pronësisë në vend kanë ekspertizën më të mirë dhe po synojmë të marrim më të mirët. Hajde të ndërtojmë një sistem ligjor të pranueshëm, pa i hequr asnjëherë qytetarit të drejtën e ankimit në gjykatë. Ligjin e 2008-ës e ka prefekti edhe sot. Tani janë fuqizuar prefektët që për këtë fashë të marrin të dhënat po nga një nëpërmjet këtyre hartave dhe ata të gjykojnë me spote, kjo zonë është dukshëm e abuzuar. Të bëjnë të gjitha verifikimet që parashikon ligji. Futet në skemë edhe Avokati i Shtetit për të vijuar më tej me anulimin apo dërgimin në gjykatë të këtyre apo edhe në prokurori për rastet e falsifikimit. Pra, kush bën letra të Rruga e Kavajës, e di që do të mbajë përgjegjësi. Janë rreth 30 mijë AMTP në këtë fashën bregdetare.

**ZONAT PROBLEMATIKE**

"Duke filluar që nga Vlorë, që vetë qyteti nuk është dixhitalizuar. Në zonën e Orikumit ka një pjesë të regjistruar, pastaj Karaburun e tatëpjetë është jashtë sistemit. Në Porto Palermo ka dy zona të hedhura dhe pastaj përsëri janë të pahedhura, duke përfshirë edhe Sarandën. Ka qenë mënyra për ta lënë jashtë sistemit dhe për ta shqyer pronën si kanë mundur dhe dashur në të gjithë këto vite", tha Lame. Ndërsa, ai ka bërë me dije edhe

Prostitucioni virtual ushtrohej në një apartament në rrugën "Reshit Petrela"

# Seks online në këmbim të pagesës, arrestohet tutorja dhe prostituta

Ina Allkanjari

Vajza të reja në kryeqytet vijojnë të bien pre e prostitucionit virtual, duke ofruar seks online në këmbim të pagesës. Policia e Tiranës në kuadër të operacionit të koduar "Chat line 5", arrestoi ditën e djeshme 2 shtetas dhe procedoi penalisht një tjetër për veprën penale "Shfrytëzimi i prostitucionit", "Mbatja e lokaleve për prostitucionin" dhe "Prostitucionin". Në pranga ka rënë Bruna S, administratorja e një studio "Chat Line" dhe që dyshohet edhe organizatorja e këtij grupi. Gjithashtu, është arrestuar edhe një 27-vjeçare A.K si dhe është proceduar një 40-vjeçare. Shtetaset e sipërpërmendura ushtronin prostitucionin virtual në një apartament që ndodhej në rrugën "Reshit Petrela" në kryeqytet. Nga puna e mirëorganizuar hetimore ka rezultuar se shtetasja B. S., 30 vjeçe, prej një periudhe 6 mujore, punëonte vajza të moshave të 18-40 vjeçe dhe i shfrytëzonte ato për prostitucion virtual, i cili zhvillohej ndërmjet internetit. Mësohet se grupi

'Chat line' në kryeqytet, vajzat paguheshin deri në 1000 euro

kishte hapur një faqe online ku klientët paguanin 50-200 euro ora kundrejt shërbimeve të seksit virtual. Për sa i përket rekrutimit të vajzave mësohet se lajmërimi për punësim bëhej online, dhe në njoftim deklarohet se paga mujore ishte rreth 1 mijë euro. Ndërkohë gjatë kontrollit apartamentin ku ushtrohej prostitucioni online u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 kompjuterë dhe pajisje të ndryshme që përdoren për kryerjen e aktivitetit. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale "Shfrytëzimi i prostitucionit", "Mbatja e lokaleve për prostitucionin" të parashikuara nga nenet 114/2 dhe 115 të Kodit Penal për shtetasen B.S., dhe për veprën penale "Prostitucioni" parashikuar



në nenin 113 për shtetasen A.K., dhe M.A.. Ky është grupi i pestë që kapet nga policia pasi akuzohet për prostitucion virtual. Më herët policia e Tiranës ka ndaluar 5 vajza, të cilat ushtronin prostitucion virtual në një

banesë në Bulevardin "Bajram Curri". Gjatë këtij operacioni në pranga ra tutorja e tyre Dafina Tresa dhe bashkëpunëtori i saj Artur Bakalli. Vajzat që punonin në këtë apartament ishin të moshës 17-21 vjeçe. Gjatë dëshmisë së dhënë më herët në polici vajzat janë shprehur se nuk i kishin treguar prindërve të vërtetën në lidhje me punën që bënin. "Familjarëve u thoshim se punojmë në call-center", janë shprehur ato. Mësohet se rekrutimi i vajzave ka ndodhur mes tyre, duke tërhequr në këtë rrjet prostitucioni virtual shoqet. "Ishte një shoqe, që ma propozoi këtë punë. Nuk e dija saktësisht se ç'do bëja. Më tha: Hajde se do të fitosh mirë. Unë kisha nevojë për para", iu ka rrëfyer njëra prej vajzave hetuesve. Por në një ndër rastet e rek-

rutimit kishte ndodhur brenda familjes, ku një prej vajzave kishte tërhequr në këtë lloj prostitucioni, motrën e vogël. Mësohet se të rejtat ishin kryesisht studente të moshës 17 deri në 21 vjeçe. Ato kanë dëshmuar se shtetasja Dafina Tresa, i orientonte se si të logoheshin në faqen "Adult work", ky zhillonin dhe aktivitetin e jashtëligjshëm. "Ishte ajo që na hapte një llogari në faqen "Adult work" me një pseudonim, numrin e llogarisë, ku klientët paguanin me kartë dhe na tregonte se ç'duhet të bënim", tregojnë vajzat. Por në një kohë që policia arreston këto grupe prostitucioni, pjesa më e madhe e tyre nuk dënohen. Kjo për faktin se Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, nuk parashikon në asnjë nen prostitucionin virtual.

## Grabiti "Benzin" në Sarandë 10 ditë më parë, arrestohet në Tiranë hajduti 24-vjeçar

**TIRANË** - Zbardhet dhe dokumentohet me prova ligjore vjedhja e një automjeti në Sarandë dhjetë ditë më parë. Pas hetimeve disaditore, policia ka bërë të mundur kapjen e autorit në Tiranë. Ai është shtetasi Mihal Llazari, 24 vjeç, banues në Himarë. Ndalmimi i tij bë i mundur pas informacioneve të siguruar nga Policia e Sarandës se ky shtetas fshihej në Tiranë. "Mihal Llazari, 24 vjeç, banues në Himarë; më datë 19.03.2018, në fshatin Berdenesh, Sarandë ka vjedhur automjetin tip "Benz", të shtetasit D.R.. Shtetas

rezulton me precedent penal në fushën e narkotikëve", thuhet në njoftimin e policisë. Mësohet se në momentin e arrestimit 24-vjeçarit i janë gjetur edhe 4 gramë substancë narkotike, e cila nuk përcaktohet dot se çfarë lloj droge është, dhe për këtë gjë do të çohet në laborator. Automjeti i vjedhur prej tij u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, ndërsa në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, u referuan materialet në ngarkim të 24-vjeçarit Llazari për veprat penale "Vjedhje" dhe "Prodhim, shitja e lëndëve narkotike".

## Genç Strazimiri: Ish-gjyqtari person me "dosje me njëllë"

### Ministria e Brendshme i përgjigjet PD: Asnjë pengesë ligjore për emërimin e Agim Hysit

**TIRANË** - Pas deklaratave të Partisë Demokratike në lidhje me kreun e ri të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Agim Hysi, ka reaguar në një deklaratë për mediat Ministria e Brendshme. Gjatë deklaratës së dhënë ministria thotë se Hysi nuk është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat por Zv/drejtor i Përgjithshëm, në mungesë të një Drejtori të Përgjithshëm. "Lidhur me deklaratën e radhës së PD-së, përmes së cilës tentohet të hidhet balte mbi procesin e vetingut në polici, i cili pas miratimit të bazës ligjore brenda pak ditësh do të nisë zbatimin, sqarojmë se: Z.Agim Hysi nuk është emëruar Drejtor i



Ministria e Brendshme

Përgjithshëm i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Ai është Zv/drejtor i Përgjithshëm, i komanduar përkohësisht prej datës 16 mars 2018, me qëllim sigurimin e funksionimit normal administrativ të institucionit, në kushtet e mungesës për momentin të

një drejtori të përgjithshëm. Ndërkohë prej datës 16 mars ka nisur procedura për përgjigjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të ri të SHÇBA-së dhe shumë shpejt është drejt finalizimit. Sjellim më vëmendjen e publikut, gjithashtu, se përveç të shkruarës si gjyqtar, z.Hysi ka shërbyer si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë në vitet 2011-2012, si dhe pranë Zyrës së Avokatit të Shtetit deri në emërimin e tij si Zv/drejtor i Përgjithshëm i SHÇBA. Nënvojzime se nuk kishte dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që z.Hysi të emërohet apo të qëndrojë në këtë detyrë. Agim Hysi është pajisur me certifikatë sigurie, vërtet nga Autoriteti për Informimin mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe ka dorëzuar rregullisht formularin e vetë-deklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, të gjitha këto përpara se të emërohet në detyrën që mban aktualisht", - deklaroi Ministria e Brendshme.

United Nations Development Programme

**TENDER ANNOUNCEMENT**

Subject: ITB – RECONSTRUCTION OF DEVELOPMENT CENTRE, VLORE MUNICIPALITY

The United Nations Development Programme System in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope and with clearly marked "ITB – RECONSTRUCTION OF DEVELOPMENT CENTRE, VLORE MUNICIPALITY" to the address below.

For more details please refer to the link below:

[http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/\\_or](http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/_or)  
[http://procurement-notices.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=45058](http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=45058)

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 10 April 2018, at 14:00 o'clock.

Address for Communication and offers' submission:

E-mail: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)  
 Str. "Skenderbeu", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor, Tirana, Albania  
 Fax: + (355) 4 2250286  
 E-mail: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Përmbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankimin për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Apartamenti" me Nr. Pasurisë 474+1-7, Zona Kadestrale 8210, Vot.4, Faqe 163, me sip. 63 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, R:Kongresi i Prermet, Pall.65, Shk.1, Ap.7, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorës Valbona Jarrili, në shumën 3'156'480 (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë.

Çmimi fillues me të cilin fillon ankandë është në shumën 6'480'000 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë, e përcaktuar në vendim gjyqësor.

Ankandë zhvillohet në datë 11.04.2018, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abd Toptani, Qendra Torre Drin, Kt.2, Nr.33, Tirana, dhe për informacion mund të kontaktoni në nr.0682099471,0684054605, email : [ermirgodaj@zyrapermbarimit.com](mailto:ermirgodaj@zyrapermbarimit.com).



**Sipërmarrësi u godit me levë, policia sekuestron kamerat e sigurisë**

**Grabitet përfaqësuesi i një firme në Tiranë, autorët i marrin 7 mln lekë**

Përfaqësuesi i një firme ndërtimi ka rënë pre e grabitësve, mesditën e djeshme në kryeqytet. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:20 në zonën e "Komunës së Parisit", në afërsi të një filiali banke të nivelit të dytë. Dy persona me motor dhe skafandër kanë arritur t'i marrin shtetasi A. S. një qese me para. Dyshohet se grabitësit i kanë marrë rreth 7 milionë lekë përfaqësuesit të firmës. Bëhet me dije se

**DËSHMIA**

"Nuk kisha ndonjë shumë të madhe, rreth 7-8 milionë lekë. Do bëja ca pagesa të firmës që përfaqësoj. Nuk i pashë fytyrat e personave që më morën qesen me lekë. Sa dola nga makina u afruan dhe më qëlluan. Nuk e di kush mund ta ketë bërë", -ka deklaruar qytetari i grabitur përpara oficerëve të policisë.

në momentin e grabitjes, dy personat e maskuar e kanë goditur me mjete të forta shtetasi A.S. dhe më pas janë larguar me një motor nga rruga "Medar Shtylla" dhe

dyshohet se kanë ikur në drejtim të Saukut. Në dëshminë e dhënë përpara uniformave blu qytetari ka treguar se me shumën e parave do bënte disa pagesa

të firmës që përfaqëson. "Nuk kisha ndonjë shumë të madhe, rreth 7-8 milionë lekë. Do bëja ca pagesa të firmës që përfaqësoj. Nuk i pashë fytyrat e personave që më morën qesen me lekë. Sa dola nga makina u afruan dhe më qëlluan. Nuk e di kush mund ta ketë bërë", -ka deklaruar qytetari i grabitur përpara oficerëve të policisë. Ndërkohë në një njoftim zyrtar policia bën me dije se ngjarja ka ndodhur në rrugën "Medar Shtylla", në një parking



Vendi i grabitjes

mjetesh në afërsi të një filiali banke të nivelit të dytë, dhe në momentin që shtetasi A. S., përfaqësuesi i një firme, ka dalë nga mjete që kishte parkuar dyshohet se dy persona me motor dhe me skafandra i kanë marrë me forcë një qese me një shumë

lekësh. Sakaq menjëherë janë ngritur pika kontrolli si dhe policia po punon për sekuestrimin e pamjeve filmike të zonës përreth. Gjithashtu, grupi po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve.

Avokati: Të vendoset një masë më e lehtë për 21-vjeçarën, është nënë e një vajze të vogël

**Helmoi vjehrrën me fostoksinë, Apeli lë në burg Marjana Cmetën**

*Detyrim paraqitje për vjehrrin e të dyshuarës, kushëririn dhe hoxhën*

Ina Allkanjari

Apeli për Krimet e Rënda vendosi ditën e djeshme të lërë në fuqi masën e sigurisë "arrest me burg", deri në përfundim të hetimeve për 21-vjeçarën Marjana Cmeta, e cila akuzohet për vrasjen e vjehrrës. Ndërkohë trupa gjyqese ka ndryshuar masën e sigurisë nga "arrest me burg" në "detyrim paraqitje" për vjehrrin e nuses vrasëse, Agim Lami, kushëririn e tij, Arben Saliu dhe për hoxhën Hysen Shehu, tek i cili autorja rrefeu krimin. Të tre personat e sipërpërmendur dyshohen se kishin dijeni për vrasjen e Lirije Lamit, por nuk deponuan kallëzim penal.

Gjatë seancës gjyqësore avokati i 21-vjeçares këmbënguli për një masë më të lehtë, duke argumentuar se e reja është nënë e një vajze vetëm disa muajshe, së cilës duhet t'i japë përkujdesje, por trupa gjyqese nuk e mori në konsideratë këtë fakt. Ndaj Marjana Cmetës rëndon akuzat e vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, e për këtë rrezikon dënimin me 35 vite burgim.

**NGJARJA**

Krimi tronditës i ndodhur në prill të vitit 2017, ku humbi jetën 47-vjeçarja, Lirije Lami, u zbulua pas një hetimi 10 mujor të prokurorisë për Krime të Rënda. 21-vjeçarja Marjana Cmeta përfundoi në pranga, pasi dyshohet se vrau vjehrrin Lirije Lami paraditen e 30 prillit në shtëpinë e saj, në zonën e ish-frutikuturës në Kamëz. Dy muaj pas krimit makabër, e reja, e cila ishte shtatzënë, vendos të shkojë tek hoxha i zonës Hysen Shehu dhe të rrefehet. Herën e parë ajo dështon të tregojë historinë, por një javë më vonë, Hoxha e thërrret për ta dëgjuar dhe vendos të regjistrojë me kamera. "Mendoja se vjehrra donte të më ndante me Oltionin. Debatet mes

**AVOKATI**

Gjatë seancës gjyqësore avokati i 21-vjeçares këmbënguli për një masë më të lehtë, duke argumentuar se e reja është nënë e një vajze vetëm disa muajshe, së cilës duhet t'i japë përkujdesje, por trupa gjyqese nuk e mori në konsideratë këtë fakt. Ndaj Marjana Cmetës rëndon akuzat e vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, e për këtë rrezikon dënimin me 35 vite burgim.

nesh ishin të forta, derisa ajo bashkë me vjehrrin ikën nga shtëpia dhe u vendosën në shtëpinë e vjetër. Atë ditë e takova Lirien, pasi kishte shpërndarë qumështin dhe po blinte disa fidanë për t'i mbjellë. E ftova në shtëpi, pasi nuk hynte asnjëherë brenda. I thashë "dua pajtim" të kalojmë mirë. Sa hyri i nxora një gotë lëng ku kisha hedhur fostoksinën. Pak minuta më vonë, filloi të bërtiste me të madhe.



21-vjeçarja Marjana Cmeta

Kisha frikë se mos zbulohesh. Hyra në dhomë dhe e gjeta duke tentuar të hapë dritaren. Përdjora përdehe. Ajo s'po jepte shpirt, mora një shall dhe tentova ta mbysja me të. Pastaj e shtrëngova me duar derisa ndërroi jetë", ka rrëfyer Marjana. Por ka qenë dëshmia e Olti Lamit, djali të viktimës, para prokurorëve, ajo çka ndihmoi hetimet për zbardhjen e krimi. Olti ka rrëfyer se kishte marrë vesh ekzistencën e një videoje, të filmuar nga hoxha Hysen Shehu. Pas dëshmisë së dhënë, u bë i mundur përgjimi i telefonatave të djalit të Lirijes me hoxhën. Pas përgjimit të bisedave telefonike, u siguroi i një ven-

dim gjykatë dhe oficerët bënë të mundur sekuestrimin e videos në zyrën e Hysen Shehut, e cila është një ndër provat që rëndon mbi 21-vjeçarën Marjana Cmeta, të dyshuar si autore të vrasjes së vjehrrës Lirije Lami. Mësohet se pas sigurimit të provave, prokurori Besnik Muçi, kërkoi nga gjykata të miratohen urdhër-arrestet për 21-vjeçarën Marjana Cmeta, e cila akuzohet për veprën penale "vrasje për shkak të rrethanave familjare". Hoxha Hysen Shehu ka lajmëruar për ngjarjen e ndodhur bashkëshortin e viktimës Agim Lamin. Gjithashtu, në dijeni ka qenë dhe kushëri i Lamit, Arben Saliu.



**Falsifikuan prokurën e noteres për çështje pronësie, bien në pranga dy persona në Tiranë**

Dy persona kanë rënë në prangat e policisë së Tiranës ditën e djeshme, se kanë falsifikuar prokurën e një noterje për një çështje pronësore toke. Bëhet fjalë për shtetasit Eduart Bakalli, 38 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, dhe Fatos Shima, 48 vjeç, banues në Tiranë. Finalizimi i operacionit të koduar "prokura", u bë i mundur nga Seksioni për Krime Ekonomik dhe Financiar në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dy personat e sipërpërmendur dyshohen se kanë falsifikuar prokurën e posaçme datë 27.11.2017, të shtetasës G.Sh., me profesion notere, një prokurë me karakter autorizim për kryerjen e veprimeve për një çështje pronësore toke në të cilin palët janë në konflikt gjyqësor. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, në ngarkim të shtetasve të më sipër, për veprat penale të "Falsifikimi i dokumenteve, i kryer në bashkëpunim" dhe "Falsifikimi i vulvave stampave ose i formularëve".

**Të shtëna me armë zjarri në Shkodër, një i plagosur**

**SHKODËR** - Të shtënat me armë zjarri kanë tronditur mbrëmjen e djeshme qytetin e Shkodrës. Ngjarja raportohet të ketë ndodhur në afërsi të shkollës "Oso Kuka", ku nga të dhënat e para mësohet se një person ka mbetur i plagosur. Bëhet me dije se personi ka marrë një plagë në këmbë. Edhe pse identiteti i të plagosurit nuk dihet ende, mësohet se ai është transportuar me urgjencë drejt Spitalit Rajonal të Shkodrës dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë që autori i ngjarjes është larguar menjëherë duke u shpallur në kërkim. Arsyet e plagosjes janë ende të paqarta, ndërsa policia e mbërritur në vendin e ngjarjes ka nisur hetimet.

Reagon Aurel Zarka: S'kam lidhje me ngjarjen, çështjen do e ndjek ligjërisht

VLORE

Një biznesmen nga Vlora është dhunuar barbarisht nga dy persona të maskuar. Altin Kaçaj, pronar i një zyre sigurimesh ka qenë duke hyrë duke hyrë në zyrën e tij në afërsi të portit të këtij qyteti, kur i është zënë prite nga dy agresorët, të cilët e kanë goditur disa herë me levë në kokë dhe më pas janë larguar me shpejtësi. Ngjarja ka ndodhur mesditën e djeshme në lagjen "Pavarsia" të qytetit bregdetar. Menjëherë është lajmëruar policia, e cila ka shoqëruar disa persona të dyshuar. Ndërsa, 42-vjeçari i plagosur është dërguar në Spitalin Rajonal të Vlorës, ku i është dhënë ndihma e parë mjekësore. Pas ngjarjes, biznesmeni Kaçaj akuzoi publikisht se pas sulmit fshihet një prokuror në Vlorë. Në një intervistë për "News 24" dhe "GSH" nga shtrati i spitalit, 42-vjeçari pohoi se para një muaj kishte denoncuar prokurorin Aurel Zarka, pasi pretendon se ky i fundit e ka arrestuar padrejtësisht. Ndërkaq, ka reaguar Zarka, i cili është shprehur se nuk ka asnjë lidhje me akuzat e Altin Kaçajt dhe se do merret ligjërisht me këtë çështje. Prokurori mohoi kategorikisht akuzat, ndërsa tha se mllëfi i Kaçajt lidhet me sekuestrimin e një makine "Jaguar" disa vite më parë, pas denoncimit të një shtetaseje italiane se automjeti ishte vjedhur.

**Zoti Zarka, biznesmeni Altin Kaçaj ju ka fajësuar ju për sulmin ndaj tij ditën e sotme (djeshme), a keni një koment?**  
Ky personi ka që para 2 vitesh që merret me mua. Po të kërkoj emrin tim në "Google", gjen vetëm komentet e këtij personi, që merret me mua për shkak të një makine që i është sekuestruar për një procedim që e kam pasur unë në dorë.

# Vlorë, maskat masakrojnë me levë në kokë biznesmenin Altin Kaçaj

## 42-vjeçari në spital: Pas sulmit fshihet një prokuror



Biznesmeni i dhunuar, Altin Kaçaj, në spitalin e Vlorës

### BIZNESMENI

Altin Kaçaj nuk është një personazh i panjohur për shkak të marrëdhënies së tij me një vajzë 24-vjeçare, e cila përfundoi në dyert e prokurorisë. Kaçaj akuzoi publikisht të dashurën në emisionin me "Zemër të Hapur" se i kishte vjedhur një shumë parash e për këtë akuzoi edhe një oficer të policisë gjyqësore, pasi sipas tij, nuk kanë pranuar provat që ai vuiri në dispozicion të tyre.

### Ai thotë që ka përfunduar edhe në burg prej jush?

Në burg nuk e kam futur unë, e ka pasur një prokuror tjetër, por ky prapë ma ngjit mua. Nuk e di pse, përballë shprehjet ndryshe.

### Domethënë, ju nuk keni lidhje me ngjarjen?

Po ç'a thua. Unë jam në

Tripot, me disa miq po ha drekë. Nuk kam lidhje me çfarë bën ai. Më ka nxjerrë edhe para dy vitesh në "News 24", më ka akuzuar për këtë rastin. Edhe atëherë më kanë marrë në telefon dhe e kam shpjeguar pozicionin tim. Është ankimuar në gjykatë, gjyka-

ta nuk ia ka dhënë. Mirë unë e paskam inat, po edhe gjykatë inat e ka?! Ai sekuestrim mjeti është.

### Ju keni pasur ndonjë kontakt me zotin Kaçaj kohët e fundit?

Absolutisht. Unë kam pasur një kontakt para rreth një muaji, para se të dilja tek "Stop". E kam sqaruar për pozicionin juridik që kam unë në lidhje me makinën e sekuestruar. Kaq kam komunikuar unë me të.

### Ju thonin që është vetëm për shkak të kësaj makinës së sekuestruar?

Atë nxori si pretendim. Çfarë lloji është kjo makinë dhe pse është sekues-

### truar?

Një makinë "Jaguar". Ka bërë denoncim një shtetase italiane që makinën nuk e ka blerë, por e ka të vjedhur. Dhe akti i shitjes, kontrata e shitje ka dalë false me akt ekspertimi. Po bën vite. Ka ikur një letër porosi në Itali. Ky pretendon që e ka blerë. Shtetasja italiane pretendon që është e vjedhur.

### Si do veproni pas këtyre akuzave?

Unë në qoftë se do merrem, do merrem në rrugë ligjore. Nuk kam çfarë të bëj më. Unë kam qëndruar indiferent. Do ta shikoj sepse tani jam njohur me akuzat dhe mund të ndjek rrugën ligjore për shpifje.

## Vrasja e dyfishitë u shënua para 2 vitesh

### Ekzekutoi dy shqiptarë në Itali, kapet 28-vjeçari Fation Stojani

**BURREL** - Policia e Mat-it ka arrestuar një person të shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje me dashje në Itali. Mësohet se specialistët për hetimin e krimin të komisarariatit e policisë së këtij rrethi në bashkëpunim me Interpol Tiranë, si rezultat i një pune të mirëorganizuar, gjatë ditës së djeshme në qytetin e Burrelit, kanë zhvilluar dhe finalizuar me sukses operacionin policor për kapjen e 28-

vjeçarit Fation Stojani (Islamaj), banues në njësinë administrative Ulëz-Mat. Sipas bluve, i riu ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, Itali, pasi Gjykata Busto, Arsizio/Itali, ka lëshuar urdhrin e arrestit ndërkombëtar për veprën penale "Vrasje me dashje". Mësohet se maksimumi i dënimit të Stojanit është burgim i përjetshëm. Ndërkaq, burimet e mësipërme sqaruan se shtetasi në fjalë me datë 10.11.2016, në qyte-



tin Conegrate/Milano, Itali ka vrarë me armë zjarri shtetasit shqiptarë me inicialet A.L.L., 31 vjeç, A.L.L., 38 vjeç. Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana po kryen procedurën e nevojshme për ekstradimin e Fation Stojanit drejt Italisë.



## Nikoll Tinaj akuzohet për falsifikim

### Tjetërsimi i pronave në Shëngjin, përfundon në pranga i kërkuari

**LEZHË** - Një tjetër person, i cili ishte shpallur në kërkim për skandalin e pronave në zonën e quajtur "Rana e Hedhun" është arrestuar dje nga policia e Lezhës. Uniformat blu kanë bërë të ditur se në pranga ka rënë 58-vjeçari Nikoll Tinaj, banues në Ishull Shëngjin-Lezhë. Ndaj 58-vjeçarit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendim nr.104 datë 26.03.2018, ka caktuar masën e sigurimit personal "Arrest në burg", për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë. Arrestimi i 58-vjeçarit u bë në vijim të operacionit të koduar "Ranishtja 4", ku pak kohë më parë u arrestuan 12 persona (mes tyre zyrtarë të bashkisë dhe të hipotekës) dhe u shpallën në kërkim 11 të tjerë. Ndërkohë që vijon puna për kapjen e 10 personave të tjerë të shpallur në kërkim.

## SHKURT

### Produkte ushqimore jashtë standardeve,

### AKU bllokoi punishten

**SHKODËR** - Një punishtë konservimi në Shkodër është bllokuar gjatë një operacioni të kryer nga AKU. Bëhet fjalë për një punishtë për prodhim, përpunim dhe shpërndarje të artikujve ushqimorë dhe që sipas AKU-së, u gjetën shkelje të kushteve të higjienës. Mësohet se punishtja është pronë e Gëzim Alisë dhe në të prodheshin artikuj të ndryshëm ushqimorë, që nga gogozharet deri tek reçelërat e djathra të ndryshëm. Ky operacion u mbështet nga Prokuroria e Shkodrës dhe Policia e Shtetit. Një vit më parë, këtij subjekti i është lënë detyrë për përmirësimin e kushteve higjienike dhe përmirësimin e prodhimit, detyra të cilat nuk janë realizuar. Pritet procedimi penal dhe nisja e hetimit ndaj përgjegjësve të kësaj puništeje.

### Përplasen dy automjete në hyrje të Levanit, plagosen 5 persona

**FIER** - Pesë persona kanë mbetur të plagosur në një aksident automobilistik të ndodhur rreth orës 14:55, në aksin rrugor Fier-Vlorë, në hyrje të Levanit. Mësohet se një automjet tip "Nisan" me drejtues shtetasin R.C. është përplasur me mjetin tip "Opel" me drejtues shtetasin R.N.. Si pasojë e përplasjes janë dëmtuar pasagjerët e të dyja mjeteve, konkretisht shtetasit: F.N., 63 vjeç, banues në Vlorë; N.K., 69 vjeç, banues në Vlorë; S.M., 19 vjeç, banues në Tiranë; Dh.N., 30 vjeç, banues në Sarandë dhe E.F., 28 vjeç, banues në Berat. Të gjithë të dëmtuarit ndodhën në Spitalin Rajonal Fier nën kujdesin e mjekëve. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur policia, e cila ka nisur hetimet për zbardhjen e shkakut të aksidentit.

### U rrëzua në orën e fizikulturës, plagoset nxënësi 12-vjeçar

**KORÇË** - Një 12-vjeçar, nxënës në shkollën 9-vjeçare të Maliqit është aksidentuar rëndë. Sipas policisë së Korçës, femija po luante me top në orën e fizikulturës dhe në një moment është rrëzuar. Për pasojë, ai ka pësuar goditje të rëndë në kokë dhe është dërguar me menjëherë në spitalin e Korçës. Por, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, 12-vjeçari është transportuar me helikopter drejt Spitalit të Traumës në Tiranë. Nga të dhënat paraprake dyshohet se ngjarja është aksidentale. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes.

## Veliaj të rinjve: Përgatitsni CV-të e vizitoni standat Panairi "Work & Study", 3 mijë vende pune të ofruara nga mbi 60 kompani

Të gjithë ata persona që janë në kërkim të një pune, kanë mundësi të aplikojnë në rreth 3 mijë vende pune të ofruara nga mbi 60 kompani e universitete të ndryshme. Ditën e djeshme u çel në ambientet e Pallatit të Kongreseve edicioni i IX i Panairit "Work & Study", i organizuar nga Bashkia e Tiranës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë si dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Kryebashkiaku Erion Veliaj, e vlerësoi këtë panair pune si një mundësi

shumë të mirë për të bërë të mundur komunikimin mes punëkërkuësve dhe punëdhënësve, posaçërisht në sektorin privat. Më tej, ai i bëri thirrje qytetarëve në përgjithësi, por të rinjve në veçanti që të vizitojnë standat e këtij panairi për të parë ofertat dhe mundësitë e punësimit. "Për të gjithë ata që na ndjekin bëni gati CV dhe hajde bëjmë një xhiro se askush nuk do vijë të ofrojë vende pune nëpër kafe", theksoi Veliaj.

Ky i fundit shtoi se kryeqyteti për shkak të mundësive që ofron shihet edhe si një vend ku shumë prej të rinjve që vijnë nga rrethet për të studiuar, vendosin të ndërtojnë të ardhmen e tyre. Duke listuar disa prej potencialëve të qytetit të Tiranës, kreu i Bashkisë përmendi dhe përzgjedhjen e kryeqytetit shqiptar si një nga tre qytetet bashkë me Parisin dhe Tel Avivin ku do të zbatohet projekti inovativ TUMA. "Dje morëm një ven-

dim tjetër të ri që ndërtesën ikonike që është këtu pranë Pallatit të Kongreseve që është Piramida e Tiranës, ta kthejmë në qendër më të madhe të teknologjisë të informacionit në rajonin tonë me kapacitet 5 mijë nxënës e të rinj që hyjnë e dalin çdo ditë për të marrë kurse të IT. Sot kemi profesione që kur unë isha fëmijë nuk ekzistojnin. Kështu që ideja e kthimit të Piramidës në një vend që pompon brenda dhe jashtë 5 mijë të rinj në ditë,



pra, le të themi, një lloj Pallati i Pioneerëve, por tani i teknologjisë të informacionit në kohët moderne, besoj që është realisht diçka që ka nevojë tregu i punës", - u

shpreh Veliaj, i cili deklaroi se ka marrë fund njëherë e mirë punësimi mbi bazën e lidhjeve politike dhe se tashmë gjithçka është e bazuar tek merita.

Këshilli i Ministrave: Zbatimi fillon në 2018-ën dhe kohëzgjatja është 5 vjet

# Vendimet e qeverisë, ndryshimet në programet e nxitjes së punësimit

"Dokumentacioni për jetimët, aftësinë e kufizuar e gratë"

### AKSIONI



Konfiskohet 73 kg mish i pavulusur në Krujë

Aksioni për veri fikimin e të gjitha thertoreve apo dyqaneve të mishit që tregtojnë pa kushte higjieno-sanitare dhe pa certifikatë veterinare po vazhdon intensivisht. AKU ka konfiskuar një sasi prej 73 kg mish qengji dhe viçi në njësinë e tregimit të mishit në rrugën e spitalit në qytetin e Krujës. Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Durrës në bashkëpunim me inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, kanë kryer inspektim në njësinë e tregimit të mishit në pronësi të shtetasit I.S, ku i janë gjetur dhe 23 kg mish viçi në mungesë të certifikatës veterinare, i pavulusur dhe tregim të tij në kushte të rënda higjieno-sanitare. Për këto shkelje të rënda në bazë të legjislacionit në fuqi, inspektorët e AKU-së e kanë gjobitur me masën administrative me gjobë në vlerën e 150 mijë lekëve. Ndërkohë që po për të njëjtën njësi tregtimi në janar të këtij viti, është marrë masë administrative me gjobë në vlerën e 100 mijë lekëve për tregtim jashtë kushteve higjieno-sanitare të produktit mish.



Voltiza Duro

Ditën e djeshme janë bërë disa ndryshime në vendimet që lidhen me nxitjen e punësimit të disa kategorive të veçanta. Respektivisht, qeveria miratoi disa ndryshime për nxitjen e punësimit të: punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta; personave me aftësi të kufizuara; grave dhe vajzave në grupet e veçanta; të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit si dhe për nxitjen e punësimit nëpërmjet formimit në punë.

### DOKUMENTACIONI

"Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës së punësimit ose të ngarkojë në mënyrë elektronike këto dokumente: Vetëdeklarimin dhe autorizimin për të lejuar nëpunësin përgjegjës të gjenerojë online dokumentacionin e nevojshëm; planin e biznesit, të detajuar; dokumentacionin justifikues për rastet e detyrimeve ndaj organeve tatimore, por që vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program", theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë të fundit bëhet me dije se zyra përkatëse e punësimit duhet të sigurojë për secilin punëdhënës aplikues: ekstraktin historik të personit fizik apo juridik, që aplikon për programin, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit; vërtetimin për pagimin e detyrimeve tatimore; si dhe vërtetimin për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit, të specifikuar për tre muajt e fundit. Gjithashtu, u vendos që "Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë" do të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2018 dhe kohëzgjatja e tij të jetë 5 vjet. Ky vendim i



### Edi Rama: Mbi 25 mijë studentë të këtij arsimit

## 3 kategoritë që përfitojnë fondin për arsimin profesional

Është miratuar fondi i posaçëm që do të nxisë formimin profesional në 3 kategori. Respektivisht në këto tri grupe bëjnë pjesë nënat kryefamiljare, të rinjtë dhe punëdhënësit që do të ofrojnë punë për të rinjtë. Kryeministri Edi Rama theksoi se më shumë mundësi punësimi kanë të rinjtë që kanë përfunduar arsimin profesional e rreth 20% e të rinjve që punësohen vijën nga ky lloj arsimit, krahunasur me atë të përgjithshëm. "Sot, ne kemi të regjistruar 25 300 studentë në arsimin profesional. Janë afërsisht 20% e totalit, por janë ende pak në krahasim me çfarë duhet të jenë për t'u përgjigjur tregut të punës.", tha Rama në fjalën e tij.



qeverisë vlen për 5 vite edhe për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta; për programin "Për masën e financimit, kriteret dhe pro-

cedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë të rinj" si dhe "Për programin e nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave nga grupet e veçanta".

### DOKUMENTACIONI

\* Për të përfituar nga programi i "NITJES SË PUNËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA", punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës së punësimit ose të ngarkojë në mënyrë elektronike këto dokumente:

- Vetëdeklarimin dhe autorizimin për të lejuar nëpunësin përgjegjës të gjenerojë on-line dokumentacionin e nevojshëm;
- Planin e biznesit, të detajuar;
- Dokumentacionin justifikues për rastet e detyrimeve ndaj organeve tatimore, por që vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program:

- kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;
- kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjobat;
- kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe janë në proces të apellimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore.

\* Për të përfituar nga programi i "NITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË", punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës së punësimit ose të ngarkojë në mënyrë elektronike këto dokumente:

- Vetëdeklarimin dhe autorizimin për të lejuar nëpunësin përgjegjës të gjenerojë on-line dokumentacionin e nevojshëm;
- Planin e biznesit, të detajuar;
- Dokumentacionin justifikues për rastet e detyrimeve ndaj organeve tatimore, por që vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program:

- kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;
- kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjobat;
- kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe janë në proces të apellimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore.

\* Për të përfituar nga programi i "NITJES SË PUNËSIMIT TË RINJVE QË KANË FITUAR STATUSIN E JETIMIT", punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës së punësimit ose të ngarkojë në mënyrë elektronike dokumentet e mëposhtme:

- Vetëdeklarimin dhe autorizimin për të lejuar nëpunësin përgjegjës të gjenerojë on-line dokumentacionin e nevojshëm;
- Planin e biznesit të detajuar;
- Dokumentacionin justifikues për rastet e detyrimeve ndaj organeve tatimore, por që vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program.

## Shëndetësi

Qumështi i bletës luan një rol kyç në organizëm, pasi i vë të gjitha organet në punë duke i bërë më dinamike në luftën ndaj virusëve. Një ndër shkaqet e alergjive të stinës janë edhe myqet e këto bëhen shkak për rritjen e shkallëve të iritimit në organizëm. **Propolisi antimyotik ul në mënyrën më drestike, shkallën e agresivitetit të sporeve të kërpudhave apo poleneve.**



Mjeku popullor: Si të dalloni simptomat, çfarë duhet të bëni kundër teshtitjes

# YLLI MERJA: Si të kuroni alergjitë e stinës me bimë mjekësore

Voltiza Duro

Në stinën e pranverës vetë klima paraqitet me temperatura të ulëta, me ndryshime e shira, me luhate të shpeshta dhe e gjithë kjo situatë mund të shoqërohet me alergji në shumë persona. Ndërkohë, në momentin që temperaturat do të rriten, pemët do të zhveshin sythat e tyre e poleni i luleve do të përhapet në ambient. Kur poleni thihet nga njeriu nëpërmjet rrugëve respiratore të frymëmarrjes, atëherë fillonë shqetësimet në organizëm. Ky i fundit irritohe dhe reagon ndaj grimcave, të cilat janë futur në mushkëri e shfaqin problematika, ku numri i leukociteve apo rruazave të bardha të gjakut fillon të rritet e më tej imunoglobulina fillon të marrë vlera të larta. Me kalimin e tyre në gjak, fillon të rritet histamina, një kimikat që kur hyn në qarkullimin e gjakut, krijon një irritim, një enjtje të rrugëve respiratore, skuqje të syve apo probleme me hundën. Në këto momente, individit i fillojnë teshtimat, ka kruajtje apo nxirrje të rrathëve të syve, skuqje të buzëve e në rastet kur këto depozitime janë mbi lëkurë, fillon të irritohe i gjithë sistemi. Të gjithë personat janë në kontakt me polenet, ngacmuesi i parë që shkakton alergji si dhe myqet që rriten në kushte shtëpie apo në ajër, por theksohet se jo të gjithë njerëzit janë alergjikë nga dy faktorët e mësipërm. Në rastet kur ulet rezistenca, njeriu është shumë i predispozuar për t'u prekur nga alergjitë e stinës, pasi këto elemente e kanë shumë më të thjeshtë që të japin efektin e tyre ngacmues dhe irritues në organizëm të dobët. Në këtë periudhë njerëzit duhet të jenë të kujdesshëm e të



përpiqen të rritin sa më shumë imunitetin.

### SIMPTOMAT

Dallimi i simptomave të alergjisë është i dukshëm e thelbësor, krahasuar me shenjat që shfaqen kur individit është i prekur nga gripi. Nëse personi ka një kollë të bezdisshme, të shoqëruar me rritje të temperaturës e këputje trupore (në këmbë e duar), me një rëndesë në mushkri dhe dhimbje koke, atëherë duhet kuptuar që këto shenja lidhen me ftohjen. Ndërsa kur njeriu preket nga polenet, ai nuk ka temperaturë, por teshtitje, rrjedhje hundësh, kruajtje sysh e nëse kruhet edhe lëkura, fillon të skuqet.

### TRAJTIMI ME BIMË MEDICINALE

Normalisht që gjatë kësaj periudhe, duhet që individit

të kujdeset shumë që të rrisë imunitetin, kështu që duhen përdorur produkte që përmbajnë flavonoide apo vita-

minë C. Nëse u japim femijëve 5-6 kokrra trëndafil të egër, atëherë do të kuptojmë që është një medikament

me të vërtetë jo vetëm rifreskues, por që ndikon edhe në rritjen e rezistencës. Gjithashtu, rekomandohet përdorimi i lëngut të limonit e portokallit, si dhe shafрани i kuq. Ndërkaq, këshillohet për të gjithë personat alergjikë, marrja e qumështit të bletës dhe propolisit. Këto dy të fundit janë testuar në rastet e personave me alergji kronike e kanë dhënë efekte të mrekullueshme. Qumështi i bletës luan një rol kyç në organizëm, pasi i vë të gjitha organet në punë duke i bërë më dinamike në luftën ndaj virusëve. Një ndër shkaqet e alergjive të stinës janë edhe myqet e këto bëhen shkak për rritjen e shkallëve të iritimit në organizëm. Propolisi antimyotik ul në mënyrën më drestike, shkallën e agresivitetit të sporeve të kërpudhave apo poleneve. Rekomandohet të

merren 10 pika nga ky medikament në ditë e kështu do të ketë një përmirësim të situatës e qetësim të mushkërive. Edhe çaji antialergjik këshillohet nga ana jonë për pacientët si dhe të bëjnë një shpëlarje të trupit me lëngun e bimëve të trumzës, gjethe e ftoit e mushmollës, në mënyrë që të largojmë nga organizmi gjithë pluhurat. Gjithashtu është mirë të përdoret një çaj rigoni apo trumzet, pak spec i kuq apo djegës që rritin së tepërmi rezistencën e organizmit, pa haruar edhe karotën. Ushqimet si qumështi, djathi, kosi nuk këshillohen që të përdoren nga personat alergjikë, pasi janë kultura shumë të përshtatshme, ku mund të zhvillohen më së miri ngacmuesit që shkaktojnë alergji. Gjithashtu, edhe çaji i kamomilit nuk duhet të përdoret pasi e vë trupin në gjumë dhe ndërkohë fitojnë terren e shumohen mikroorganizmat që shkaktojnë alergji. Në rastet kur individët kanë bllokim të sipërm të rrugëve të frymëmarrjes, pra të hundës, atëherë duhet të përdorin vajin e dafinës, i cili ka efekte të mrekullueshme në luftimin e alergjisë, pasi përmban flavonoide që minimizojnë irritimet. Njerëzit që kanë lotim të syve nga alergjia duhet t'i shpëlarjnë fillimisht me ujë të ftohtë, ose me çajin e cianës, e pas kësaj të bëjnë një lyeje nga jashtë me hudhër, ndërsa në rastet e kollës së thatë duhet të përdoret lulja e thundër-mushkës apo propolisi.



Darina Tanushi

Këshilli i Ministrave ka përcaktuar kriteret e gradimit të oficerëve, nën oficerëve dhe ushtarakëve në rezervë, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr.59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes. Ushtaraku në rezervë, me përfshirjen e tij në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura, titullohet dhe i jepet grada ushtarake që ai ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura. Pjesë e rezervistëve mund të bëhen ushtarakët, deri në moshën 45 vjeç, për ushtarë/detarë dhe nënoficerë meshkuj, deri në moshën 35 vjeç, për ushtarë/detarë dhe nënoficerë femra, deri në moshën 50 vjeç, për oficerë meshkuj si dhe për oficerë femra deri në moshën 40 vjeçare. Titulli "Oficer rezervist" dhe dhënia e gradave madhore për oficerët me grada madhore bëhet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes. Ushtarakëve në rezervë (oficer, nënoficer dhe ushtarë/detar) u lind e drejta e gradimit të radhës kur plotësojnë kriteret e përgjithshme të gradimit, arsimimit dhe kualifikimit, të përcaktuara në krerët II e III, të këtij vendimi.

#### VENDIMI I PLOTË:

#### I. TITULLIMI DHE GRADIMI I USHTARAKËVE NË SHËRBIMIN REZERVIST

1. "Ushtarak në rezervë" është ushtaraku që ka shërbyer në Forcat e Armatosura dhe, pasi ndërpret karrierën ushtarake aktive, përfshihet në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura.

2. Ushtaraku në rezervë, me përfshirjen e tij në strukturat rezerviste të Forcave të Armatosura, titullohet dhe i jepet grada ushtarake që ai ka pasur në momentin e ndërprerjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura.

3. Mund të bëhen pjesë e shërbimit ushtarak në rezervë ushtarakët, të cilët kanë shërbyer në parë në Forcat e Armatosura dhe plotësojnë kriteret e moshës, si më poshtë vijon:

a) deri në moshën 45 vjeç, për ushtarë/detarë dhe nënoficerë meshkuj;

b) deri në moshën 35 vjeç, për ushtarë/detarë dhe nënoficerë femra;

c) deri në moshën 50 vjeç, për oficerë meshkuj;

d) deri në moshën 40 vjeç, për oficerë femra.

4. Titulli "Oficer rezervist" dhe dhënia e gradave madhore për oficerët me grada madhore bëhet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

5. Titulli "Oficer rezervist" dhe dhënia e gradës ushtarake për oficerët deri në kolonel/kapiten i rangut I bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ose të Komandantit të Forcave të Armatosura.

6. Titulli "Nënoficer dhe ushtar/detar rezervist" dhe dhënia e gradës ushtarake deri ushtar/detar IV ose kryekapiter bëhet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose të Komandantit të Forcave të Armatosura, me propozimin e Qendrës së Personel Rekruitimit (QPR).

7. Ushtarakëve në rezervë (oficer, nënoficer dhe ushtarë/detar) u lind e drejta e gradimit të radhës kur plotësojnë kriteret e përgjithshme të gradimit, arsimimit dhe kualifikimit, të përcaktuara në krerët II e III, të këtij vendimi.

8. Titujt dhe gradat e ushtarakëve në rezervë janë të njëjta me ato që parashikohen në aktet ligjore në fuqi për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura.

9. Gradimi, sipas këtij vendimi, bëhet në përputhje me nevojat organike dhe kapacitetet e strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për përbalimin e gjendjes së krijuar.

II. KRITERET E PËRGJITHSHME TË GRADIMIT

1. Ushtaraku i shërbimit në rezervë merret në shqyrtim për marrjen e gradës së radhës kur plotësojnë këto kriteret:

Zbardhet vendimi i qeverisë, mund të rihyjnë meshkujt deri 50 vjeç

# Ushtarakët në rezervë, kriteret dhe procedura për t'u rritur në gradë

Jo më pak se 3 periudha vjetore për të marrë titullin oficer



a) Ka plotësuar kohën minimale të qëndrimit në shërbimin në rezervë, sipas kreut III, të këtij vendimi;

b) Ka kryer arsimimin dhe kualifikimin e nevojshëm për marrjen e gradës së radhës;

c) Më shumë se gjysma e vlerësimeve, gjatë qëndrimit në shërbimin në rezervë, nuk është më e ulët se "kënaqshëm";

c) Është i aftë fizikisht dhe në gjendje shëndetësore të mirë.

2. Emërtimi, kohëzgjatja dhe programi i arsimimit e kualifikimit për marrjen e gradës së radhës miratohen nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

3. Kurset dhe kualifikimet e kërkuara për personelin ushtarak në rezervë, që shërben në strukturat e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe të Policisë Ushtarake (Seksioni kriminal), njësohen me kurset dhe kualifikimet e kërkuara për marrjen e gradave, sipas këtij vendimi, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

4. Mënyra dhe formati i vlerësimit për periudhën e qëndrimit në shërbimin rezervë është e njëjtë me atë të shërbimit aktiv. Vlerësimi i jepet ushtarakut në përfundim të çdo periudhe aktivizimi në shërbimin rezervë.

5. Plotësimi i kushteve për përparimin në gradë verifikohet nga QPR-ja, e cila bën edhe propozimet përkatëse tek autoriteti kompetent ose autoriteti propozues, sipas pikave 4, 5 e 6, të kreut I, të këtij vendimi.

6. Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të shkronjës "ç", të pikës 1, të këtij kreu, miraton rregulloren e aftësive fizike, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

#### III. KOHA MINIMALE E QËNDRIMIT NË SHËRBIMIN NË REZERVË PËR MARRJEN E GRADËS SË RADHËS

1. Ushtarakët rezervistë të Forcave të Armatosura, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e qëndrimit në shërbimin në rezervë, si më poshtë vijon:

##### a) Oficerët:

I. Nëntogeri/nënlejtant, për të fituar gradën "toger/lejtant", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 3 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 12 ditë;

II. Toger/lejtant, për të fituar gradën "kapiten/kapiten lejtant", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 3 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 16 ditë;

në total, se 16 ditë;

III. Kapiteni/kapiten lejtant, për të fituar gradën "major/kapiten i rangut III", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 5 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 20 ditë;

IV. Majori/kapiten i rangut III, për të fituar gradën "nënkolonel/kapiten i rangut II", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 6 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 24 ditë;

V. Nënkoloneli/kapiten i rangut II, për të fituar gradën "kolonel/kapiten i rangut I", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 5 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 20 ditë;

VI. Koloneli/kapiteni i rangut I, për të fituar gradën "gjeneralbrigade/kundëradmiral", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 5 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 20 ditë;

VII. Gjeneralbrigade/kundëradmirali, për të fituar gradën "gjeneralmajor/nënadmiral", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 3 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 12 ditë;

VIII. Gjeneralmajori/nënadmirali, për të fituar gradën "gjenerallejtant/admiral", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 3 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 12 ditë.

##### b) Nënoficerët:

I. Ushtari/detari IV, për të fituar gradën "nëntetar", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 3 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 12 ditë;

II. Nëntetari, për të fituar gradën "tetar", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 3 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 12 ditë;

III. Tetari, për të fituar gradën "rreshter", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 4 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 16 ditë;

IV. Rreshteri, për të fituar gradën "kapter", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer

në strukturat rezerviste jo më pak se 6 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 24 ditë;

V. Kapteri, për të fituar gradën "kryekapter", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 5 periudha vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 20 ditë.

##### c) Ushtarët:

I. Ushtari/detari I, për të fituar gradën "ushtar/detar I", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 1 periudhë vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 4 ditë;

II. Ushtari/detari II, për të fituar gradën "ushtar/detar II", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 1 periudhë vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 4 ditë;

III. Ushtari/detari III, për të fituar gradën "ushtar/detar III", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 1 periudhë vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 4 ditë.

IV. Ushtari/detari IV, për të fituar gradën "ushtar/detar IV", të jetë aktivizuar dhe të ketë shërbyer në strukturat rezerviste jo më pak se 1 periudhë vjetore si dhe të ketë shërbyer në këto struktura jo më pak, në total, se 4 ditë.

##### IV. TË FUNDIT

1. Gradën deri "nënkolonel", për oficerët në rezervë, dhe gradën deri "kapter", për nënoficerët në rezervë, që kryejnë detyra organike në specialitete në strukturat e Forcave të Armatosura, si mjekë dhe personel i orkestrës frymore, ushtarakët e përfitojnë sipas kohës së qëndrimit në shërbimin në rezervë dhe jo sipas kriterëve të arsimimit e kualifikimit.

2. Kur oficerët rezervistë kërkojnë të përparojnë në gradë e karrierë, autoritetet përkatëse u ofrojnë kurset e nevojshme të arsimimit dhe të kualifikimit.

3. Vendimi nr.431, datë 2.7.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e gradimit të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarakëve rezervistë", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI  
EDI RAMA

Agjencia e Trajtitimit të Pronave: Përfituesit kanë edhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuar, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar dhe që janë vlerësuar

# Lista III/ Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen

Kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitet 1993-1997 rreth 17 318 vendime

financiarisht e publikuar nga ATP-ja është 17 318 vendime. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e vitit 1997 së bashku me vlerën financiare.

## MUNGESA E DOKUMENTACIONIT

Sipas ATP-së, në rastet kur subjektet e interesuara nuk sjellin dokumentacion të nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit të kompensimit brenda afatit 6-mujor nga data e publikimit të regjistrimit, si dhe në rastet

kur ATP-ja është në kundërsi objektivë për të vlerësuar pronën, bazuar në dokumentacionin që disponon vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht. Pronarët kanë edhe 4 muaj kohë për plotësimin e dokumenteve dhe ATP njofton të gjitha subjektet, që për çdo informacion apo paqartësi lidhur me të dhënat e publikuara në regjistrim apo që nuk i gjejnë të publikuara në të, mund të paraqiten pranë sporteleve tona për sqarime dhe informacion

më të detajuar. Gjithashtu, ATP ka filluar punën dhe së shpejti do të përfundojë procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1998 dhe në vijim sipas rendit kronologjik do të vlerësohen të gjitha vendimet, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## DOSJET E PËRFUNDUARA

Me përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të

vendimeve përfundimtare të vitit 1997, si dhe nga përditësimi i regjistrimit të vendimeve për vitet 1993-1996, numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP është 17 318 vendime. ATP, nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.133/2015 e deri më tani ka përfunduar vlerësimin financiar për 67% të të gjithë

vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me ecurinë e punës së deritanishme, kjo falë edhe sistemit "Web-Gis" të implementuar nga ATP, ky proces parashikohet të përmbyllet përpara afatit të përcaktuar në ligj për përfundimin e vlerësimit financiar të të gjitha vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

### EMRAT E 1462 PRONARËVE QË KOMPENSOHEN

Fier	Pandeli Berdalli	1,224,427
Fier	Ibrahim Baci	
Fier	Gani Boriçi	
Fier	Kristaq Kitani	3,807,930
Fier	Hetem Radeshi	
Fier	Xhevdet Toska	
Fier	Sherif Hazizaj	
Fier	Sotir Gjika	
Fier	trashëgimtarët	
Fier	Hekuran Maneku	6,333,726
Fier	Vasillaq Como	
Fier	Halit Marina	
Fier	Ismet Mema	
Fier	Vangjel Bitri	
Fier	Faik Cepele	
Fier		1,302,911
Durrës	Sabri Jella	
Durrës	Miranda Loli	
Durrës	Goni Sijoni	
Durrës	Hasan Karagjozi	2,326,740
Fier	Brahim Tishkezi	
Durrës	Jorgaq Stasi	2,898,100
Durrës	Eqrem Kruja	
Korçë	Seit Myrtollari	311,270
Dibër	FALI ALIMANI	129,535
Dibër	HYSEN TASHA	74,345
Korçë	Demir Barbuta	3,147,055
Korçë	Njavir Barbuta	5,816,813
Fier	Shuaip Sinani	
Lezhë	Pjeter Mark Kola	126,931
Durrës	Ilir Goci	
Durrës		
Elbasan	AISHE ALIKO	193,144

Elbasan	HANIFE SALLAKU	285,187
Elbasan	SALIE RIZA KARRIQI	-27,128
Elbasan	MAKASEN, SELMAN, ASTRIT BUNGA	
Korçë	Sabri Spaho	
Korçë	Rapo Muharemi	
Korçë	Llazi Saro	610,000
Korçë	Mihal Goca	874,530
Tiranë	KSENIE GJOKA	14,371,547
Elbasan	XHEVIT DRIZA	485,789
Elbasan	ASLLAN ZOGU	773,753
Elbasan	ISLAM SHYQYRIU	497,301
Elbasan	MALIQ KRYEMADHI	514,161
Elbasan	ALI ZENEJA	536,396
Elbasan	VEIZ CEKREZI	4,883,839
Elbasan	IDAJET LLALLA	1,621,874
Elbasan	RAZIM BALLABANI	132,496
Elbasan	KASO TAFI	11,474,410
Tiranë	AZIZ, MUSTAFA, IBRAHIM, REXHEP SH	
Tiranë	AZIZ, MUSTAFA, IBRAHIM, REXHEP SH	
Tiranë	ZOGA, MARGARITA N	1,540,287
Korçë	Iljaz Maze	1,009,482
Korçë		114,238
Korçë	Ismail Turku	245,845
Korçë	Shyqyri Avdullari	213,425
Korçë	Agim Gjore	32,634
Korçë	Pandeli Gjika	103,790
Korçë		720,642
Korçë		269,819
Korçë	Qamil Oldashi	1,057,656
Korçë		59,467
Korçë	Xhemal Çela	1,291,815
Korçë	Nazmi Pere	1,701,028

Korçë	Hajdar Sadikaj	1,511,841
Tiranë		310,074
Tiranë	SHABAN SHABANI	
Tiranë	VELI AHMETI	
Tiranë	AGIM PREZA	
Tiranë	SULEJMAN VESHI	
Gjirokastrë	Petraç Gorishani	-1,164,185
Korçë	Qamil Hyska	
Korçë		-937,840
Tiranë	DEDJA	7,031,745
Tiranë	SHPETIM ZAJMI	-17,065,968
Korçë		0
Korçë	Qamil Hyska	675,273
Korçë	Lefter Samara	768,199
Tiranë	ALUSH DELIU	1,170,000
Kukës	Rexhep Ismail Parlaku	683,856
Korçë		596,230
Durrës	Englantina Mehmeti ( Golemi )	
Korçë		275,932
Fier	Thanas Bakalli	2,120,118
Fier	Ali Llanaj	
Fier	Halim Behari	
Fier	Irakli Toska	23,729,021
Fier	Thoma Meço	
Fier	Kilo Stoja	7,190,412
Fier	Thoma Meco	7,616,852
Fier	Arben Boriçi	5,870,249
Fier	Stavri Cuko	4,530,628
Fier	Thoma Gjeçi	1,418,230
Fier	Sotir Meço	
Korçë		12,443,256
Lezhë	Llesh Nikoll Dudi	
Durrës	Naim Dollaku	

Durrës	Njazi Milaqi	
Durrës	Ana Sotiri	5,011,440
Tiranë	DYLBERE BAKALLI	33,350,562
Durrës	Raqi Dimo	2,200,650
Dibër	SALI SEIT ZENELI	
Dibër	AHMET DALTI	
Tiranë	BEDRI BEGA	
Tiranë	Hajdije Derhemi	-26,251,842
Gjirokastrë	Zylfo Katiraj	
Korçë	Gëzim Xhibani	311,300
Korçë	Nikollaq Sheremeni	243,263
Korçë	Gani Çuçllari	680,919
Korçë	Ligor Visi	2,472,740
Korçë	Pirro Greço	602,664
Korçë	Llazar Ruço(Shardho)	198,245
Korçë	Kristaq Koço	1,525,650
Korçë	Gurie Hysenllari	395,480
Korçë	Adriatik Pojani	1,451,838
Korçë	Xhevair Kulla	2,116,849
Korçë	Anesti Kristo	2,302,795
Fier	Janul Leshi	
Korçë	Ylli Poloska	
Durrës	Ali Tupi	
Tiranë	MUSTAFA MACI	2,891,070
Tiranë	BESIM HASMETA	15,447
Lezhë	Mark Preng Ndreca	393,186
Tiranë	MUSA KRUIA	-4,611,240
Korçë	Zenel Toska	172,638
Elbasan	NUMRIE XHAKA	2,444,371
Elbasan	RUSHAN DERMYSHI	1,735,668
Elbasan	BASHKIM LLALLA	4,047,909
Elbasan	DILAVER LLALLA	520,238
Elbasan	QAMIL MANE	946,588
Elbasan	SKENDER TOCILA	1,928,201
Elbasan	SHABAN FEJZULLAU	2,043,048
Fier	Rrapo Myrselaj	
Fier	Muhamet myresehi	-3,480,328
Korçë	Qazim Hamolli	524,082
Korçë		370,520
Korçë		314,745
Korçë	Behije Çela	565,280
Korçë	Gafer Kapa	231,598
Korçë	Sadik Ahmeti	379,070
Korçë	Skender Rexhollari	1,002,039
Korçë	Mihallaq Bice	734,550
Korçë		569,036
Korçë	Emin Hoxha	-5,134,681
Korçë	Nazar Mimini	-1,996,200
Korçë		850,924
Korçë		173,442
Korçë	Llazi Gusho	104,372
Korçë	Gjyladin (Xheladin) Afislla	298,346
Korçë	Nikolla Vako	768,353
Korçë	Piro Llazo Mehili	-4,980
Korçë	Esmë Elezi	507,580
Korçë	Vlazëria Çollaku	
Kukës	Rame Ali Ramallari	30,805
Kukës	Myftar Aslan Cena	-651,233
Kukës	Enver Mustaf Elezi	0
Kukës	Ferit Arif Elezi	
Fier	Hyqmet Myrsela	
Korçë	Demir Bajraktari	0
Korçë	Qemal Palla	154,379
Dibër	ABAZ KOLA	
Durrës	Qamil Merlika	500,000
Fier	Kristaq Stambolliu	15,151,164
Fier		
Fier		3,495,305
Fier	Zija Perkazi	
Fier	Bujar Cane	
Fier	Flamur Zavalani	1,123,299
Fier	Kadri Kodheli	
Fier	Zoi Ndreko	2,866,473
Fier	Mane Ferko	2,463,375
Fier	Spiro Sauli	
Lezhë	Zenun Sheta	
Lezhë	Lume Xhepa	
Elbasan	SHAQR HIMA	6,053,956
Elbasan	XHEMILE DASHI	489,465
Elbasan	MEHMET FAQOLLI	669,076
Elbasan	TAFIL REXHEP KERCI	491,151
Elbasan	BIHANE PRRENJA	276,937
Korçë	Uran Kostreci	
Korçë	Myftar Tare	
Korçë	Bektash Male	106,272
Dibër	Beqir Koçi	
Korçë	Qerim Tahiri	1,325,701
Korçë	Dallendyshe Xhafëri	
Korçë	VIKTOR KAPXHILLARI	
Korçë	Selami Afëz Begollari	349,000
Korçë	Hasan Cenko	
Korçë	Gjergji Mborja	-2,450,500
Korçë	Guri Vantazi	36,816
Korçë	Eftimija Vantazi	676,713
Korçë	Mbarime Dulellari	379,600
Korçë	Myfit Hena	-7,505,400
Korçë	Mihal Sotiri	155,978
Korçë	Bido Luarasi	416,232
Korçë	Beqir Beqiri	1,871,730
Korçë	Demir Shkëmbi	480,247
Korçë	Hasan Cenko	827,940
Korçë	Hasim Terolli	
Korçë	Dilaver Muço	1,204,636
Korçë	Baris Pera	389,944
Korçë	Nazar Kajtira	1,763,368
Gjirokastrë	Riza Hajnaj	3,447,927
Shkodër	Ded Kaçi	
Fier	Shahin Majaci	
Fier	Josif Bare	747,051
Fier	Llambi Bare	
Fier	Selim Hoxha	
Fier	Nexhip Hoxha	
Fier	Haziz Mahmutaj	2,342,401
Fier	Kozma Ndreko	7,626,669
Fier	Avni Braçe	3,115,904
Fier	Haxhi Brace	
Dibër	FERIDE GUGA	1,706,000
Dibër	SADETE SHEHU	430,100
Fier	Petrit Zariu	
Shkodër	Zef Ndoka	
Shkodër	Hamit Mus Mehaj	0
Kukës	Raniz Dan Istrefi	1,889,975
Kukës	Isuf Rushit Cengu	-780,290
Elbasan	HAJRIE TAHIRAJ	5,662,627
Elbasan	KADRI TAHIRAJ	
Elbasan	SAMI KADIU	-29,747,200
Fier	Hariz Ferko	
Fier	Osmen Xhafa	
Fier	Mihal Mecalliu	1,335,388
Fier	Aristir Çuko	
Fier	Brahim Fera	
Korçë	Farije Shaholli	517,189
Fier	Gora Nushi	7,015,236
Gjirokastrë	Refie Vrekaj	
Gjirokastrë	Nevro Dalani	
Korçë	KIMET KOLLICINAKU	
Korçë	Hysen Orhan	341,600
Korçë	Hysen Orhan	149,301
Korçë	Hysen Orhan	53,808
Kukës	Mustaf Neza	346,756
Lezhë	Muhamet Rama	
Tiranë	HAKI ALLA	672,000
Tiranë	ALLA	
Tiranë	NADIRE ZELA	806,400
Gjirokastrë	Shyqyri Dulo	361,941
Gjirokastrë	Qatip Hysoskendaj	1,562,557
Korçë	BEDRI GANE	154,949
Korçë	Gjenci Kosturi	5,080,083
Korçë		54,592
Gjirokastrë	Duro Kopo	475,953
Gjirokastrë	Skender Beqari	952,358
Fier	Ali Osmani	3,971,501
Fier	Qamil Isufi	780,800
Fier	Lili Bare	658,937
Fier	Themi Dema	
Fier	Myzafer Hoxha	
Fier	Nuri Balaj	
Fier	Fuat Zyberi	
Fier	Xhemil Braka	10,077,451
Fier	Kristaq Prifti	

Fier	Hasime Ndreu		Korçë	Saip Isa Duli	360,400	Tiranë		1,478,358
Fier	Telemak Nushi	7,975,670	Fier	Asqeri Hyskaj		Tiranë	SANJE HOXHA	-19,004,720
Fier	Hedie Delibashi	5,286,821	Tiranë	MENDUHIJE GJECI	-2,858,672	Tiranë	JONUS HOXHA	0
Fier	Sherif Krasniqi		Tiranë		4,419,954	Tiranë	Muharrem Asllani	2,812,698
Fier	Gori Vidhi		Korçë	Gezim Orhani	373,636	Tiranë	Tefik Gjinali	-182,656,432
Fier	Idajet Feleqi		Korçë	Behije Duci	480,323	Tiranë	ALLA	
Fier	Ndoni Gjini	7,194,291	Korçë	Resmije Pasho	38,736	Tiranë	MEHMET DAJA	-186,025,000
Lezhë	Mark Gjok Ruci	1,113,195	Korçë		393,093	Tiranë	REXHEP PICIRI	4,754,799
Fier	Vullnet Serjani		Gjirokastër	Astrit Mezini		Tiranë	ALI QORALIU	-121,688,409
Korçë	Vasfi Çekiçi	979,956	Fier	Ali Tafa	2,944,209	Tiranë		-18,256,560
Korçë	Mersin Ibi	705,626	Fier	Isuf Metanaj		Korçë	Vangjeli Gjeli	221,400
Korçë	Haki Kapa	4,015	Shkodër	Ejll Gjoni		Korçë	Bashkim Minga	1,048,857
Korçë	Lytfi Ibi	757,542	Lezhë	Preng Nikoll Marku	285,504	Korçë	Beqir Bardhi	
Korçë	Sefedin Palla	171,966	Fier	Rronje Pashaj	574,592	Korçë	Zydi Meço	452,307
Korçë	Nazar Shkullaku	403,473	Korçë	Vladimir Kroj		Korçë	Thimi Risto	417,307
Korçë		253,133	Korçë	Azem Zenullari	1,003,491	Korçë	Haxhire Bylykbashi	551,731
Korçë	Elmas Çela	950,095	Tiranë	ALI DERVISHI	2,827,531	Shkodër	Meliha Beqi Ulqini	
Korçë	Muhamet Berberi	451,974	Tiranë	IBRAHIM ALLA	896,000	Shkodër	Tonin Cekljej	3,387,378
Korçë	Isa Çaush Bramellari	155,905	Tiranë	NEBI DURO	3,101,984	Fier	Fejzi Gropa	7,120,000
Korçë	Sofije Sotir	0	Tiranë	BEDRIJE MOLLA		Korçë	Imir Zhuli	
Tiranë	ZYHDI FORTUZI		Tiranë	RAMAZAN PETI	-349,625,600	Elbasan	SOFIE ALLKO (KURTI)	475,384
Tiranë	ABDULLA TAGANI		Tiranë	RAMAZAN PETI	-297,898,471	Elbasan	QANI KOKONOZI	-672,720
Lezhë	Lek Frrok Gjoni		Tiranë		-15,377,546	Lezhë	Pashk Lufi	
Tiranë	KADIA, (SUFNIQI) IBRAHIM		Korçë	Mustafa Myrtollari	674,713	Lezhë	Sadri Reçi	
Tiranë	SEIT, SEHIT CULLHAJ	804,144	Korçë	Lefter Tili	2,651,334	Fier	Qamil Hoxha	
Tiranë	SHAQIR ALLA	0	Korçë	Sulejman Hysenllari	89,062	Fier	Lame Shahini	4,101,254
Tiranë	DAJLAN OMERI	2,758,342	Korçë	Gaqo Tili	1,445,181	Fier	Ymer Nuhaj	51,214
Tiranë	HAXHI GURI		Korçë	Mustafa Piliçi	38,203	Fier	Thanas Gërxi	441,025
Korçë	Barije Agolli	141,888	Korçë	Ferit Tahirlari	217,875	Fier	Tatjana Zoto	
Korçë		227,215	Korçë	Mbarime Dulellari	2,657,804	Fier	Pandefi Laze	3,003,074
Korçë		336,000	Korçë	Petrit Bankallari	1,220,509	Durrës	Marie Çoça	-130,191,000
Korçë	Edije Kello		Elbasan	NEVRUZ TAFI	4,103,592	Tiranë	XHEMAL SYZIU	412,307
Korçë	Edije Kello	490,199	Elbasan	ISUF KOÇI	297,355	Tiranë	SHAQIR ALLA	
Lezhë	Marte Gjok Ndoja	141,781	Elbasan	DEMIR AGOLLI	574,592	Tiranë		
Shkodër	Gjeke Preka		Korçë	Hasan Mazelli	786,782	Tiranë	FATOS AJAZI	
Gjirokastër	Aslan Imeri		Korçë	Floresha Belli	-287,216	Shkodër	Fredinand Pistulli	1,200,255
Korçë	Nafije, Kadri Spaho	921,762	Korçë	Lutfi Ibi	448,344	Shkodër	Shpetim Bushati	2,002,049
Korçë	Shyqyri Dikollari	72,722	Korçë		411,648	Shkodër	File Marashi	385,846
Korçë		1,184,530	Korçë	Arifë Gjata	228,752	Shkodër	Esat Bushati	
Korçë	Teki Hoxha	2,318,209	Korçë		279,988	Shkodër	Vehibe Kazasi	991,452
Lezhë	Ndue Gjergj Perloja		Korçë	Ligor Gjergo	206,347	Shkodër	Shyqyrie Hallani	1,866,665
Tiranë	ENVER BALLA	-3,818,689	Korçë		455,718	Shkodër	Marije Hila	197,538
Korçë	Pavli Dimashi	450,430	Korçë	Sotiraq Kreste	345,600	Shkodër	Adem Halili	70,154
Durrës	Spiraq Kulja		Korçë	Koli Kapardhi	72,912	Durrës	Muhamet Domi	0
Durrës	Pranvera Deliallisi		Korçë	Piro Tasellari	415,000	Durrës	Sulejman Lila	1,148,717
Lezhë	Ndue Gjergj Kolziu		Korçë	Riza Hoxhallari	-179,040	Durrës	Ismail Çangu	751,264
Korçë	Vexhde Heri	836,035	Korçë	Aleksandra Vesho		Durrës	Vath Stafuka	588,311
Korçë	Viktor Agolli	500,650	Korçë			Gjirokastër	Erbap Stroka	
Korçë	Refihan Telo	166,000	Lezhë	Pashk Perndoj		Gjirokastër	Mero Beges	
Korçë	Gazi Luja	8,400	Shkodër	Viktor Kumrja	60,602	Gjirokastër	Selman Como	326,496
Korçë	Sofia Ropi		Shkodër	Bukurije Kali	2,911,027	Gjirokastër	Tomor Bendo	-7,200,000
Korçë	Mitke Lapi	50,000	Shkodër	Gjon Gjeshi	614,095	Lezhë	Serafin Gjoka	
Korçë	Sejfi Sadikaj	352,200	Shkodër	Qani Kadija	4,605,714	Fier	Zaim Myftari	3,687,107
Korçë	Alije Hoxha	310,000	Shkodër	Ismail Kombi	276,343	Lezhë	Rasim Bercaj	
Lezhë	Gjin Mark Kola	351,938	Shkodër	Pjerin Deda	1,473,828	Fier	Ymer Korçari	2,084,100
Tiranë	DEMNERI	3,505,011	Tiranë	SEFER ABAZI				
Lezhë	Mehill Zef Prenga	37,205						
Korçë	Bexhe Kolaneci							

(vijon)



Ish-presidenti serb: Arrestimi i Gjuriç ishte shfaqje e përgatitur

# Arrestimi i Gjuriç, Lista Serbe braktis qeverinë e Kosovës

Vuçiç: Opozita do të ketë mbështetjen tonë

**L**ista Serbe dje mori vendimin që të largohet nga qeveria e Kosovës, por deputetët e saj do të vazhdojnë të qëndrojnë në Kuvendin e Kosovës. Siç kanë konfirmuar jo zyrtarisht për gazetën "Danas" nga e ashtuquajtura Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Lista Serbe do të vazhdojë të qëndrojë në Parlamentin e Kosovës. "Deputetët e Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës do të vazhdojnë të luftojnë për të drejtat e bashkësisë serbe në Kosovë", kanë thënë nga Zyra që udhëhiqet nga Gjuriçi. Vendimi i Listës Serbe për largim nga Qeveria e Kosovës pasoi zhvillimet në Mitrovicë pas arrestimit të shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç, nga Policia e Kosovës. Ndërsa për presidentin serb Aleksandar Vuçiç, dhuna që ushtrioi policia e Kosovës ndaj Marko Gjuriçit ka thelluar ndarjen mes serbëve të veriut dhe Prishtinës. Vuçiç foli në një intervistë për televizionin publik RTS menjëherë pas vizitës së kryediplomatës europiane Mogerini në Beograd. Presidenti serb thotë se Beogradi do t'i japë tashmë ndihmë të drejtpërdrejtë Listës Serbe. "Lista Serbe do të qëndrojë në opozitë për të luftuar për popullin e saj dhe do të marrë ndihmë nga shteti serb". Vuçiç nuk beson se largimi i Listës Serbe nga qeveria do të shkaktojë probleme në Kosovë. "Nuk mendoj se qeveria e Prishtinës do të bjerë, sepse shqiptarët bashkohen kur janë në vështirësi, ndryshe nga serbët, të cilët e kanë të vështirë të veprojnë si rastin e Marko Gjuriçit apo të Vuçiçit në Srebrenicë. Gjithsesi, e rëndësishme është që ata të kenë një lider të fortë që di sesi të ecë përpara duke marrë parasysh interesat e Serbisë". Presidenti serb garantoi se pavarësisht dhunës që u ushtrua ndaj një ministri nga Beogradi në Kosovë, populli serb në këtë vend kurrë nuk do të bjerë pre e dhunës dhe do të punojë gjithnjë për paqen dhe stabilitetin. Për këtë, Vuçiç siguroi edhe shpenzimet e politikës së jashtme të Bashkimit Europian, Federikës Mogerini. Ndërkohë që kryetari i Partisë Social Demokratike të Serbisë (SDS) Boris Tadiç ka deklaruar se arrestimi i Marko Gjuriçit në Mitrovicë është bërë sikurse film, në të cilin



Presidenti serb Aleksandar Vuçiç

**ALEKSANDËR VUÇIÇ:**

"Nuk mendoj se qeveria e Prishtinës do të bjerë, sepse shqiptarët bashkohen kur janë në vështirësi, ndryshe nga serbët, të cilët e kanë të vështirë të veprojnë si rastin e Marko Gjuriçit apo të Vuçiçit në Srebrenicë. Gjithsesi, e rëndësishme është që ata të kenë një lider të fortë që di sesi të ecë përpara duke marrë parasysh interesat e Serbisë".

**BORIS TADIÇ:**

"Mediat pro regjimit kanë shkruar për ngjarjen para se ajo të ndodhte. Si në çdo shfaqje tjetër skenari është shkruar para performancës", tha ish-presidenti i Serbisë. Presidenti Vuçiç ka një "taktikë që është e bazuar në një zjarr për të ndezur konflikte me kroatët, boshnjakët dhe tani me shqiptarët, e cila ka për qëllim që të mblehd kombin rreth një karakteri të 'liderit shpëtimtar'".



## DASH: Të shmanget përshkallëzimi i situatës mes Kosovës dhe Serbisë

Zëdhënësjë e Departamentit Amerikan të Shtetit, Heather Nauert ka reaguar lidhur me ngjarjet në veri të Kosovës, në Mitrovicë. Nauert, përmes një deklarate për shtyp, thotë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dënojnë fuqishëm ngjarjet e së hënës në Mitrovicë, të cilat u tha në mënyrë të panevojshme se rrisin tensionin dhe kërcëjnë stabilitetin rajonal. "Ne ju bëjmë thirrje të gjithë palëve ta shmangin përshkallëzimin e mëtejshëm të situatës dhe të veprojnë me qetësi dhe të t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore. Për të krijuar paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në Ballkan, Kosova dhe Serbia duhet të fokusohen në normalizimin e raporteve përmes dialogut", thuhet në deklaratë. Më tej pohohet se Shtetet e Bashkuara janë të gatshme të mbështesin të dyja palët në bisedime.

**SHKURT**

## Të shtëna me armë në fushatën e ish-presidentit

Të paktën dy autobusë në karvanin e fushatës zgjedhore të ish-udhëheqësit brazilian Luiz Inacio Lula da Silva u sulmuan me armë zjarri të martën, sipas Partisë së tij të Punëtorëve. Sekretariati i Sigurisë Publike të Paranës tha në një deklaratë se po hetonte incidentin dhe se Lula nuk ishte në autobus në kohën kur ndodhi ngjarja. Sipas "Reuters", në sulmin e ndodhur në shtetin jugor të Paranës, një plumb kaloi mes për mes autobusit, duke përfunduar në xhamin e një automjeti tjetër. Lula ishte president i Brazilit nga 2003 deri në 2010 dhe po kërkon një mandat të tretë në zgjedhjet e tetorit, pavarësisht nga se ai akuzohet për korrupsion, gjë që e ndalon atë të kandidojë për këtë detyrë.

## Kim Jong Un viziton Kinën, ja çfarë kushtesh parashtrori

Pas disa ditë spekulimesh konfirmohet se lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong-un, ka vizituar Kinën. Vizita e tij është konfirmuar si nga Kina, ashtu edhe Koreja e Veriut. Sipas mediave kineze, biseda mes dy liderëve Kim Jong-un dhe Xi Jinping shkoi mjaft mirë. Raportohet se lideri i Koresë së Veriut i ka siguruar homologut të tij kinez se është i përkushtuar për të hequr dorë nga armët bërthamore. Mes kushteve të Koresë së Veriut përfshihet edhe heqja e garancisë bërthamore nga ana e SHBA-ve për Korenë e Jugut. Kina ka bërë të ditur se vizita nuk ishte zyrtare, ndaj dhe nuk njoftuan paraprakisht. Kim Jong-un mbërriti në Kinë me një tren të ngjashëm me atë që përdorte babai i tij. Kjo është vizita e parë e Kim Jong-un jashtë vendit që bëhet publike qëkur ka marrë detyrën në vitin 2011. Kim Jong-un pritet të takohet me Presidentin e Koresë së Jugut, Moon Jae-in në prill dhe me Presidentin amerikan Donald Trump në maj. Vizita e Kim Jong-un në Pekin konsiderohet si një hap i rëndësishëm për përgatitjet e Penianit për bisedimet me Presidentin amerikan, Donald Trump.

## Provokimet turke? Greqia aktivizon forcat "Delta" në Egje

Ministri grek i mbrojtjes, Panos Kammenos ka urdhëruar përpunim të stërvitjeve të jashtëzakonshme në Dodekanisa, Egje. Lajmi është bërë i ditur nga mediat greke, të cilat theksojnë se në stërvitje janë aktivizuar edhe Forcat Speciale "Delta", ndërsa kjo mësohet të jetë hera e dytë që stërviten në pak ditë. Skuadra "Delta" është ajka e ushtrisë greke, forcat më të specializuara për përballimin e situatave më kritike, në kriza të mëdha etnike. Aktivizimi në këtë periudhë sipas mediave greke tregon pikërisht seriozitetin e situatës. Forcat "Delta" do të stimulojnë skenarë zbarkimi në



tokë përmes anijeve amfibe si edhe ato të mbrojtjes në rast të një sulmi nga deti. Ushtrarakët vëzhgues nga Athina bëjnë të ditur se stërvitjet e shpeshta nuk janë rastësi, por reagon strategjik ndaj palës turke, sidomos pas ak-

tivizimit të stolis Navtex që kufizon hapësirë të gjerë në Egje. Një gjë të tillë e ka shprehur edhe kryeministri grek Tsipras, i cili tha se ka ardhur koha që Turqia t'u japë fund provokimeve.

kanë marrë pjesë edhe zyrtarët e Qeverisë së Serbisë. Tadiç tha se Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriç dhe përfaqësuesit e Listës Serbe vullnetarisht morën rolet si në teatër, dhe se në këtë "teatër" morën pjesë edhe Hashim Thaçi dhe Ramush

Haradinaj. "Mediat pro-regjimit kanë shkruar për ngjarjen para se ajo të ndodhte. Si në çdo shfaqje tjetër, skenari është shkruar para performancës", tha ish-presidenti i Serbisë. Tadiç tha se ishte e qartë se shkruarja e delegacionit serb në Mitrovicë nuk ishte e miratuar nga

ana e autoriteteve kosovare. Ai tha se presidenti Vuçiç ka një "taktikë që është e bazuar në një zjarr për të ndezur konflikte me kroatët, boshnjakët dhe tani me shqiptarët, e cila ka për qëllim që të mblehdë kombin rreth një karakteri të 'liderit shpëtimtar'".

## DEBATI

# "TEATRI, PROJEKT KLIENTELIST"

## Deputetët debat me Kumbaron, ministrja tërhiqet: Është vetëm propozim

Fatmira Nikolli

Një projekt klientelist! Kështu e kanë cilësuar deputetët e opozitës në Komisionin parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik projektin e qeverisë për Teatrin Kombëtar.

Para ministres së Kulturës, Mirela Kumbaro, e thirrur në një seancë dëgjimore ata qenë të ashpër. Dëgjesa zgjati pesë orë dhe mes palëve pati debate të ashpra, ndërsa ministrja la komisionin, pasi deputetët e ndërprisnin.

Përfaqësuesit e akuzuan ministrin se qeveria po merr përsipër të zhvillojë një projekt klientelist, ndërsa kryetarja e komisionit, Albana Vokshi i tha Kumbaros se kanë hequr qëllimisht godinën e teatrit nga zona muzeale-historike dhe se, sipas një dëshirë të kryeministrit Edi Rama, teatri do të shembet.

Ministrja Kumbaro, në përgjigje të pyetjeve, nuk shqiptoi në asnjë moment se godina e teatrit do të shembet ose jo, por theksoi se projekti që u prezantua disa ditë më parë ishte një propozim i vetofruar nga një kompani ndërtimi dhe i bazuar tek një studim i territorit të Tiranës dhe ndryshimeve të tij pas vitit 2000.

Sipas Kumbaros, projekti është ende një koncept dhe po shqyrtohet nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia e Tiranës.

**DEKLARATAT KONTRADIKTORE RAMA-KUMBARO**

Më 12 mars, ditën kur projekti u prezantua, kryeministri Edi Rama tha se "godina aktuale do shembet dhe mbi gërmadhat e së shkuarës do ngrihet Teatri i ri Kombëtar. "Ai është pjesë e një propozimi për Partneritet Publik Privat nuk do të jetë një teatër me kullë", theksoi kryeministri. Shtoi se, "nga 3000 metra, do kemi 9000 metra katrore në dispozicion. Nga një sallë e vetme sot, do kemi katër salla nesër, ku nga hapësira të përpshkrueshme e poshtëruese për dinjitetin e çdokujt që i thotë vetes artist, do ketë hapësirë më të madhe për ta. Salla kryesore do ketë 620 poltrone, ku krijohet edhe një sallë e re e hapur mbi teatër me mbi 100 vende. Ka edhe dy sallat të reja të tipit 'blackbox' me nga 100 vende secila. Do të kemi një teatër që do jetë trefshë i këtij që është sot dhe do ketë një sistem të tërë infrastrukture për shfaqjet që sot nuk ekziston".

Si për të çimentuar deklaratën e tij, shefi i qeverisë, theksoi se: "Ne do të avancojmë që projekti të realizohet brenda vitit të ardhshëm. Teatri do të jetë baza e pro-

Ministrja e Kulturës në komisionin, opozita i kërkon dorëheqjen: Ju mashtroni



Në foto: Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro dhe në Komisionin e Medias

jektit".

Por, dy javë më pas, ministrja 'përgënjeshtroi' kryeministrin.

Në komision, Kumbaro tha dhe se "nuk kemi një vendimmarrje në kuptimin juridik të fjalës nga qeveria. Kryeministri ka ftuar arkitektin Bjarke Ingels si pjesë e propozimit të ardhur pranë Bashkisë së Tiranës për një koncept, të prezantojë atë koncept, duke shprehur një vullnet politik për të ndër- tuar teatrin".

Ministrja e Kulturës shtoi në përgjigje të pyetjeve të deputetëve se: "Nuk kemi kërkuar projekt as ne si Ministri Kulturë, as qeveria. Subjekti privat (një kompani) ka

sjellë një kërkesë. Kompania private ka propozuar një koncept nëpërmjet arkitektit Bjarke Ingels. Në momentin që ky koncept erdhi zyrtarisht pranë Bashkisë Tiranë, ishte vullneti politik i menjëhershëm për ta ndarë këtë koncept me publikun. Këtë kërkesë, për një projekt të Teatrit Kombëtar, jemi duke e shqyrtuar. Jemi pikërisht në këtë fazë, të shqyrtimit. Të gjitha këto i kemi bërë publike. Në vijim të çdo vendimmarrje që do ketë, do ta bëjmë publike dhe do të jetë objekt i konsultimit dhe i ndarjes me opinionin publik; qofshin ata komuniteti i artistëve, i arkitektëve apo i gazetarëve".

### DEBATE E AKUZA NË KOMISION

Në pesë orë, debatet mes ministres dhe deputetëve të opozitës qenë të ashpra. Pas një sërë pyetjesh nëse do të shembet Teatri Kombëtar, Vokshi i ka kërkuar Kumbaros të japë dorëheqjen, duke e quajtur atë të paaftë. Kjo e fundit ka refuzuar të dorëhiqet, duke sqaruar se godina e Teatrit Kombëtar ka shfaqur shumë here probleme dhe shembje të pjesë të ndryshme.

Kumbaro replikoi duke thënë se "nuk e jap dorëheqjen. Unë flas për dokumente zyrtare. Në emër të Teatrit Kombëtar janë shpenzuar 6 milionë dollarë, por projekti u ndërpre. Kryeministri shpreh vullnetin politik për një godinë të denjë teatri. Mënyra si do të ndërtohet do të jetë rezultat i procedurës ligjore. Do të ndërtojmë teatër të ri, sepse teatri për të cilin flasim është në kushte skandalozë. Turp të keni!".

Dorëheqjen Kumbaros ia kërkoj edhe deputeti i djathtë, Luçiano Boçi, i cili i tha ministres të urdhërojë menjëherë ndalimin e punimeve ose të largohet, duke shtuar se teatri po prishet për një arsye qesharake, për faktin se nuk është "monument kulture".

Në mbrojtje të ministres foli deputeti i PS-së, Bujar Çela, i cili u shpreh se "ne e duam teatrin, duam gjithçka të mirë, teatri nuk është monument kulture. Opozita nuk është në gjendje të përfaqësojë popullin. Po debatojmë kot".

Pas tij, ndërhyri Kejdi Mehmetaj (LSI) që tha se "po thuhet të pavërteta. Kërkohej që qytetarët të



bëhen për budallenj, si dhe të luhet me çështje të rëndësishme. Kolegët e mazhorancës janë të detyruar të mbulojnë çmenduritë e Ramës. Ju, z. ministre bini në kundërshtim me fjalët e tua. Problemet që thoni ju janë bërë për shkak të lëvizjes së themeleve. Kur kishit kaq shumë shqetësime, pse nuk bëhët asnjë studim?".

Për deputeten e LSI, Nora Malaj, çështja e teatrit është çështje trashëgimie, teatri nuk është vetëm i atyre që interpretojnë, por i të gjithëve. "Është detyrë kush-tuete e jona që të mbrojmë të gjitha institucionet, duke i trajtuar me shumë seriozitet. Duket një kalvar i gjatë mundimesh i njerëzve, ne jemi këtu për të dhënë zgjidhje. Është krijuar një situatë e jashtëzakonshme. Ne do jemi para popullit deputetë të paaftë, nëse nuk japim zgjidhje, Parlamenti do të quhet shterp".

Duke mbrojtur vendimet e qeverisë, Fadil Nasufi (PS) tha se, "jemi futur në një hulli institucionale, gjithë Shqipërinë e ka zaptuar informaliteti, projekte me shpenzime marramendëse. Sot na rrëmben pasioni i madh për gjëra që janë drejt shkatërrimit, për të ndërtaur gjëra të reja, që edhe ky brezi që është sot të lërë gjurmët e veta".

Edhe Shezai Rrokaj e mbrojt teatrin duke theksuar se ai "duhet të veçohet nga çdo lloj nisme që mund të ketë në atë zonë. Çdokush që është rritur në Tiranë e konsideron këtë teatër pjesë të historisë së vet. Trashëgimia më e madhe kulture janë artistët, njerëzit. Këta njerëz, ky kontribut, kjo dije nuk duhet të fshihet. Teatri është pikë reference historike, pa të cilën nuk ekziston dot kujtesa. Teatri është pjesë e identitetit të një vendi. Ky teatër nuk duhet parë si një gjë që po shkatërron, ai edhe mund të shembet, të prishet, por ne duhet të ndërtojmë një të tillë edhe më të mirë, aty, si pjesë e rikthimit të kujtesës. Ndajhem shumë i prekur nga ky problem. Refuzohen takimet me njerëzit e çmuar të këtij vendi. Politikanët shkojnë e vijnë, shkencëtarët, artistët do të mbeten. Teatri duhet të bëhet nga shteti dhe duhet të jetë pjesë e veçuar, të ketë fizionominë e tillë që t'i shërbejë vazhdimësisë së kujtesës kombëtare".

Më e ashpër ishte deputetja Albana Vokshi: "Keni thënë se mungon harta, por keni gënjyer. Ja ku është harta, e kemi ne. Ju nuk dini se çfarë keni, nuk po bëni dot detyrën tuaj. Në relacionin tuaj keni thënë se nuk hiqet, por zgjerohet. Në fakt, e kemi hequr, ju kemi mashtuar Kuvendin".

## KASTRIOT ÇIPI: "PASAPORTA" ME 9 FUNKSIONE E GODINËS



Në foto: Regjisori Kastriot Çipi

**1950** - Themelohet Filarmonia Shqiptare, sot Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit dhe Ansambli Popullor.

**1952** - Themelohet Estrada e Tiranës, sot Teatri i Metropolit dhe Cirku i Tiranës, sot Cirku Kombëtar, i vetmi në Ballkan.

**1959** - Themelohet Shkolla e

Lartë e Aktorëve "Aleksandër Moisiu", më pas Instituti i Lartë i Arteve, më pas Akademia e Arteve, sot Universiteti i Arteve.

**1962** - Themelohet Konservatori Shtetëror i Tiranës.

**2011** - Themelohet Teatri Kombëtar i Komedisë, sot Teatri Kombëtar Eksperimental.



Tërheqja e ministres? E shikoj këtë si një strategji të mirëmenduar. Nuk e kanë hallin te projekti, e kanë hallin të pranohet fakti se do të ngrihen kullat, si fakt i kryer.

Fatmira Nikollë

Më mbetet dilemë: si ka mundësi që kthyer aktorët e regjisorët tanë më të nderuar brenda një nate, nga 'do të vdesim për teatrin' në 'na pëlqen projekti'. Këtu nuk ka si të mos shkojë mendja se qeveria u bëri presion".

Shkrimtari Rudi Erebara lajmëroi të martën një protestë qytetare para Teatrit Kombëtar për mbrojtjen e godinës historike. Pak orë më vonë, ai do të njoftonte se aktorët janë kërcënuar që të mos dalin në protestë. E, megjithatë, një grusht qytetarësh, ia behën në orën 18:00 mes dy godinave që rrezikojnë ekzistencën, edhe pas 1 muaji e gjysmë proteste nga artistët.

Erebara, shkrimtar në zë, i vlerësuar për romanin "Epika e yjeve të mëngjesit" edhe nga vetë ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro, bëri çmos që protesta të mbaje.

Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" ai tregon se përse u përfshi në çështjen e teatrit (në të cilën ka artistë që nuk përfshihen), pse vendosi të protestojë dhe pse mendon se aktorët janë kërcënuar.

Erebara vëren se për të "Teatri Kombëtar nuk është si dyqanet e kohës së komunizmit, që u privatizuan nga shitësit e Sigurimit me vendim të PPSH".

**- Pse u përfshij në protestë, çfarë të nxiti?**

Unë kam qenë në dijeni të pu-

sisë së përhershme që i kishin nguritur teatrit që në 2004 e diçka më herët. Deri pak javë më parë sikur e nuhatëm pusinë të gjithë bashkë edhe kam diskutuar me disa miq të mi aktorë e regjisorë. Ndanim shpesh përqasje të ndryshme. Por, në përgjithësi unë dhe shumica e miqve të mi të teatrit, aktorë, regjisorë e spektatorë, ishim për ruajtjen. Unë jam të rikonstruktuar ashtu siç është. Këta që janë sot në qeveri kanë urrejtje të pafund të shkatërrojnë çdo dëshmi historike që i ka ngritur qytetit të Tiranës. Nuk lanë dy gurë bashkë. Kanë mbjellë më shumë fjetore se pemë. Bëjnë beton fjetore edhe beton qendrash tregtare. Çfarë më nxiti? Dita Ndërkombëtare e Teatrit. "Vetmia" e kolegëve të mi artistë, njerëz të nderuar e me integritet moral të pacenueshëm që dolën të thonë 'jo'. Unë i bëra thirrje Partisë Demokratike Shqiptare, të gjithë opozitës shqiptare të bashkohet me qëndrimin qytetar kundër oligarkisë së fjetoreve prej betoni. Edhe ditën e hënë që vjen, në orën gjashtë do të jemi të gjithë bashkë të tregojmë se nuk tërhiqemi. Janë këta që në katër vitet e fundit shkatërruan Sheshin "Skënderbej", stadiumin "Qemal Stafa", brenda të njëjtës arkitekture simbolike të bulevardit të Tiranës. Nëse nuk i ndalojmë, unë nuk e di se ku do të mbarojnë këta, çfarë duan të bëjnë? Të na përzënë të gjithë nga ky vend që na e bënë të pabanueshëm!

Duhet të ikim të gjithë që këta të vazhdojnë të bëjnë miliarda? Kjo është çmenduri. Po shtuhuret i gjithë kombi. Nuk gjen në Tiranë një cep muri, një tjegull a një portë t'u tregosh fëmijëve ku ke qenë, si ishte, ku ke luajtur. Ku ke çarë kokën, e ku je rritur me kokëçarje. Asnjë vend.

**- Kush i ka kërcënuar artistët që të mos marrin pjesë në të?**

Artistët i kanë kërcënuar me bukën e gojës, siç bëjnë shpesh këta. Nuk do shumë mend e kalem kjo punë. Ndoshta edhe me ndonjë hapje dosjesh. E heqin nga puna, nuk u japin fonde për projekte teatore. Kaq mjafton. Me rrogën e teatrit me sa di unë, pa projekte, janë për bukën e gojës. Megjithatë, më mbetet dilemë si ka mundësi që të nderuar brenda një nate, nga "do të vdesim për teatrin" në "na pëlqen projekti". Këtu nuk ka si të mos shkojë mendja se qeveria u bëri presion.

**- Një shkrimtar që proteston për teatrin, kur ka aktorë që janë me qeverinë... Çfarë po ndodh me shoqërimin shqiptare?**

Aktorët që janë me qeverinë jam i bindur se po luajnë një rol të detyruar nga rrethanat. Disa madje më thanë që nuk e duam PD në protestë, sepse politizon situatën. Unë u thashë që jam përkthyes i plot dramave, edhe shkrimtar, por në raport me teatrin unë jam i barabartë me cilindo aktor a regjisor, thjesht si spektator. Teat-



Në foto: Shkrimtari Rudi Erebara

# Rudi Erebara:

## E mbroj, se ata që do vdisnin për teatrin, ndërruan mendje dhe pëlqejnë projektin

*"Për teatrin jam i barabartë me spektatorin socialist, atë demokrat, ballist apo legalist"*

për teatrin, brenda një viti i bën populli aq lekë sa të bëjë jo një, por dy teatro. Kështu që ky justifikimi i shpifur nuk kemi lekë ta bëjmë teatrin edhe do ta japim tek privati është i rremë. Sa për projektin e ri, më është dukur qesharak. Një kioskë e fillim viteve '90, ku do të silllesh si nëpër aeroporte mes tezgave me rroba e 'çikullatave' të gjesht hyrjen e sallës së shfaqjeve. Një projekt qesharak edhe mbi të gjitha i pavend në historinë tonë kombëtare.

**- Ministrja e Kulturës ka deklaruar në Komisionin e Medias, se projekti i Bjarkë Ingels për Teatrin Kombëtar, është vetëm një propozim dhe se mbi këtë çështje, nuk ka ende asnjë vendim-marrje. A është kjo një tërheqje e qeverisë?**

Unë e shikoj këtë si një strategji të mirëmenduar. Nuk e kanë hallin te projekti, e kanë hallin të pranohet fakti se do të ngrihen kullat, si fakt i kryer. Kullat do të hyjnë doemos në territorin e teatrit, në një mënyrë a një tjetër dhe për pozicionin e caktuar, trulli ku shtrihet teatri kombëtar do të jetë kantier ndërtime. Vetë lakimi i këtij projekti me ngrehinin që duket rreth 4 katëshe me gjithë atë vëllim të madh, duket si i sajuar me kast të mbulojë kullat nga mbrapa.

Që të mos zgjatet, kjo puna e vendimmarrjes do të tërheqet edhe për ca kohë, sa të rikthejnë pedonalen në rrugë makinash sipas fjalëve që thuhet se aty kalon unaza e vogël. Më duket se kur u bë pedonalia kushtoi mbi një milion euro, disa thonë edhe një milion e gjysmë. Nuk dihet sa ka kushtuar saktë sheshi 'Skënderbej' rreth e rrotull, por janë dëgjuar shifra 17 milionë, 18 milionë, 6 milionë. Sikur t'i biem përgjysmë ta zëmë për të vërtetë, kanë shtruar me pllaka një shesh, edhe kanë bërë një parkim 20 milionë euro, një shkollë 9-vjeçare kushton 1 milion euro, edhe nuk paska Shqipëria aq sa të bëjë një teatër 5 milionë euro, kur nga të gjithë shembujt më lart, vetëm teatri është një investim që sjell para. Kështu që nuk e shikoj si tërheqje të qeverisë, por si shtyrje.

ri është në radhë të parë i spektatorit. Edhe spektatorit socialist, edhe atij demokrat, ballist apo legalist. Por ne jemi përballë faktit që Partia Socialiste kërkoi të shembë teatrin dhe Partia Demokratike është me ne kundër. Ku ka politikë këtu? Po punë e madhe se ka politikë. Këtu jemi të gjithë bashkë të shpëtojmë historinë tonë. Teatri Kombëtar nuk është si dyqanet e kohës së komunizmit, që u privatizuan nga shitësit e Sigurimit me vendim të PPSH. Teatri Kombëtar është dhe do të mbetet në radhë të parë i spektatorit artdashës, ashtu si çdo teatër i botës në të cilin aktorët dhe regjisorët janë edhe vetë spektatorë.

**- Pse e krahasuat protestën për teatrin me atë antikomuniste e '90-ës?**

Në 1990 ishin në bashkë me Partinë Demokratike kundër po këtyre që janë sot në qeveri. Po ta shikojmë me emra, shumë pak risi ka lista. Ne shpikëm si shpëtim Partinë Demokratike, edhe kjo parti sot e ka me detyrim të jetë me ne aty në ballë të mbrojtjes historinë e kombit shqiptar.

Si e thashë, jemi përballë faktit të paekuvok, Partia Socialiste e Shqipërisë kërkoi të shembë Teatrin Kombëtar. Të gjithë njerëzit e ndershëm që duan këtë vend duhet të jemi bashkë.

Në 1990 ishim të rikonstruktivim jetët tona nga rënjoja që la komunizmi. Sot jemi të rikonstruktivim Teatrin Kombëtar. Kam bërë një llogari të vogël. Nga 1000 lekë të vjetra në muaj për frymë, sikur të hedhim të gjithë në një kumbar

Opinion i Ditës

# BËHU DHE TI KONTRIBUES NË GJETJEN E ESHTRAVE TË TË ZHDUKURVE SE JE SHQIPTAR!

Besim NDREGJONI

(Vijon nga faqja e parë)

... shoqëri civile e të qytetëruar. Nga përgjigja e plotë e tyre varet, në fakt, mbarëvajtja e shoqërisë në përgjithësi, dhe natyrisht edhe shoqërisë shqiptare. Shqipëria mban në ndërgjegjen e saj disa nga gjërat më dramatike për një komb. Njëra pjesë e kombit të saj u përndoq në mënyrën më të pamëshirshme, u përndoq për bindjet e saj, për pasurinë e saj, për rangun dhe inteligjencën, për kodet e saj etike

krime, por përkundrazi me mënyra të streholluara përdorën diktatin ndaj kësaj pjese të shoqërisë që nuk u bë palë me diktaturën," harresën".

Harresa është një fenomen që nuk i shërben paqes, lirisë, por diktaturës. Duke ndjekur me vëmendje aktorët politikë mediatike si dy shtylla të fuqishme të pluralizmit, kemi parë se fenomenin e harresës ndaj vlerave dhe dijës së kombit, e mbulojnë me gënjeshtëri, ideologjinë nga vjen kjo klasë politike. Më anën e pushtetit të diktatit të fshijnë dijen që na kan lënë trashigimi këta burra e gra që janë

të tjerëve në Maliq e Beden. Është e turpshme e asapak kombëtare të flitet për kontribute e atyre që i sollën kësaj shoqërie diktaturë e të heshtet ndaj këtyre që u sakrifikuuan që në të kemi liri. A kanë moral drejtuesit e pushtetit të sotëm të nderojnë xhelatët që u humbën eshtrat këtyre shqiptarve dhe të përbuzin korifejtë e lirisë të mendjes e të dashurisë njerzore!

Dhe veprat e këtyre martirëve të ditur, të zhdukur sot mbas 28 vitesh presin nga kjo klasë politike

Të ua kthejnë eshtrat, t'i qetësojnë familjarët, t'u ndërtojnë një varr në tokën mëmë Shqipëri.

vrان për liri, për këtë demokraci që flasim sot. Por ndërgjegjen e tyre e ka mbuluar heshtja, heshtja e tyre është krimi i dytë që u bëhet martirëve që u vranë për liri dhe sot nuk kanë një varr në vendin e tyre.

Heshtja është veprim kriminal ndaj të vranëve e të zhdukurve nga diktatura komuniste për jetët e humbura për mijëra vite e vuajtje nga diktatura dhe krimi.

Mos hesht se bëhesh fajtor! Po, gjetjes së eshtrave të zhdukurve.

Është koha të veprimi e të kapim kohën e humbur! Është koha të ndërtojmë parcelën Ko-



e kombëtare, u përndoq për pesë breza. Vetëm se ishte e tillë.

Kur një shoqëri nuk do të ballafaqohet më ndërgjegjen e vet për të bërë pastrimin e së keqës, ajo shoqëri do të vazhdojë të jetë traumatike: Të nesërmen, kushedi, mund ta ketë më të errët se të djeshmen.

U mbushën 28 vite që nuk janë gjetur eshtrat e 4500 të pushkatuarëve pa gjyge nga diktatura. Dhe sot ata vazhdojnë të jenë të zhdukur dhe të harruar nga klasa politike.

Këta korifejtë të kombit tim sfiduan padrejtësinë e terrorit me anën e vlerave të tyre, duke u martirizuar; gjënë më të shpejtë jetën. Këta korifejtë sfiduan padrejtësinë, duke sakrifikuar moshën, por jo idealin e lirisë, drejtësisë paqes për shoqërinë.

Që në vitet e para të demokracisë, në ënderronim që padrejtësia e një sistemi çnjerzor komunist do të denohet moralisht dhe penalisht.

Fatëkeqësisht sot kur po mbushen 28 vite të ndërrimit të sistemit, ne shqiptarët, e në veçanti politika nuk i dënuan këto

sot në këtë sallë, me trashigimtarët e tyre, dhe me shkëlqimin e vlerave të tyre kombëtare duket sikur bisedojnë me ne, duket sikur dhe sot mbas terrorit na frymëzojnë që ne të punojmë për të mirën e shoqërisë e të kombit.

Deri kur drejtësia të penalizojë padrejtësinë kjo shoqëri nuk mund të ketë paqe, dhe dashuri. Ne jemi dëshmitarë okularë të atmosferës së frikës që krijon çdo terror, sidomos terrori i kuq. Ne gëzojmë të drejtën e fituar me gjak për fjalën e lirë, mendimin e lirë, veprimtarinë e lirë e ligjore ma shumë se asnjeri tjetër.

Kjo e drejtë nuk është një privilegj, por një e drejtë që nuk mund të mohohet nga askush.

E kur ajo mohohet -siç është rasti shumë herë në vitet e fundit- e drejta e jonë për revoltim është e shenjtë, dhe e pacenueshme.

Ku janë eshtrat At Gjergj Fish-tës, të Patër Anton Harapit, Lef Nosit, Maliq Bushatit, ku janë eshtrat e At Aleks Lipës të Sazan Hadëri në burgun e Burrelit, të Xhelal Koprencës në Spac e mijëra

A është e qetë shoqëria kur në 105-vjetorin e pavarësisë, flitet për pamvarinë, dhe ata që bënë pavarësinë si Lef Nosi, Fejzi Alizoti, me të tjerë sot nuk kanë një varr? Ka 28 vite që ky shtet i ashtuquajtur demokratik, ka financiar me mijëra subjekte e individë, kurse për gjetjen e eshtrave të vranëve të diktaturës nuk ka dhënë as edhe një cent. Janë gjetur afërisht 2000 të vranë nga viti 1944-1990 e deri më sot, pa ndihmën e shtetit, por vetëm familjarët me shpenzimet e veta. Aq përbuzëse është përgjigja e këtij shteti ndaj këtij fenomeni kombëtar sa të përgjigjen me indiferentizëm se nuk ka dosje për të pushkatuarit, sikur këta i ka marrë ndonjë pushtues e i ka larguar jashtë Shqipërie.

Kosova e pushtuar 100 vite nga serbët kërkoi 2000 qytetarë të zhdukur. Ne të pushtuar nga diktatura komuniste për 50 vite kërkujmë 4500 të zhdukur.

A ka ndërgjegje kombëtare presidenti, parlamentin, qeveria, kur një pjesë e shoqërisë kërkoi të drejtën njerëzore të respektojë ata që u

mbetare me emrat e tyre përballë godinës së qeverisë siç kanë ndër-tuar hebrejtë përballë Budestangut gjerman parcelën e kujtesës e ku Merkel çdo vit u kërkoi falje për krimet e Hitlerit. A do të kërkoi falje Edi Rama, Gramoz Ruçi, e Ilir Meta, Sali Berisha, siç kërkoi Lulzim Basha dje me 26 mars 2018 në konventën kombëtare të familjarve që nuk i kanë gjetur eshtrat, siç bëjnë gjermanët!

Kthimi i eshtrave familjarve, ndërtimi i parcelës kombëtare para selisë së qeverisë është mirnjohja, paqja, dhe pajtimi kombëtar i shoqërisë dhe shqiptarve.

Bëhu dhe ti kontribues në gjetjen e eshtrave të të zhdukurve se këta të zhdukur janë shqiptarë janë bashkombasit tuaj janë ata që i dhanë këtij vendi pamvarinë, që i dhanë këtij vendi shtetin, që i dhanë këtij vendi lirinë duke sakrifikuar jetën e tyre!

\* President i Unionit Mbarëkombëtar Integritit të Burgosurve dhe Përndjekurve Politik të Shqipërisë

### HOROSKOPI

**DASHI**

Nëse po shqyrtoni mundësinë për një udhëtim, për argëtim apo për punë, mos u ktheni mbrapa. Parashikohen përvoja shumë interesante në vijim! Mund të pasuroni bagazhin e juaj kulturor me njohje dhe njohuri të reja. Me të vërtetë shumë mirë.

**DEMI**

Mos u hidhni shumë përpjetë, nëse nuk doni të rrezikoni të rrezoheni! Duhet të qëndroni më këmbë në tokë dhe të mos përfshihen nga aventura tepër të rrezikshme. Mendoni për pasojat e veprimeve që kryeni, do të shmangnit rrezikun për ta pësuar.

**BINJAKET**

Kujdes nga kokëfortësia, sepse mund të sjellë gjëra të pakëndshme. Më mirë të udhëhiteni nga dikuj që ka më shumë përvojë sesa ju. Përvoja ju mëson, por nëse nuk jeni të sigurt për diçka njëqind për qind, nuk duhet as ta provoni.

**GAFORJA**

Nëse në të kaluarën keni marrë një ndihmë të papritur, tani është koha ta ktheni favorin pa u tërhequr mbrapsht. Në fund edhe ju do të shpërbleheni. E rëndësishme është t'ia nisni mbarë, nganjëherë gatishmëria vlen më shumë se çdo gjë tjetër.

**LUANI**

Sot do të do të vëni në jetë ide nismëtare. Jeni të palodhshëm, të aftë për të punuar pa ndaluar. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkaloni masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë!

**VIRGJERESHA**

Ata që varen nga ju nuk bëjnë punën e tyre ashtu siç prisni, qortojni sigurisht, por pa e bërë të madhe. Nuk keni arsye perse ta bëni. Më mirë thuajini gjërat siç janë, pa shumë lojë fjalësh, në mënyrë të qartë, të drejtëpërdrejtë dhe të saktë.

**PESHORJA**

Shfrytëzoni favorizimin që planetet kanë ju për të zmadhuar dhuntitë e juaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët e juaja. Nganjëherë nuk duhet të lodheni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

**AKREPI**

Keni të bëni me çështje të brendshme dhe familjare të pazgjidhura dhe mund ta shfaqni më shumë sesa duhet nervozizimin. Përpqini ndërkëq të jeni i mirëkuptueshëm. Mund të gjeni gjithmonë një pikë të përbashkët dhe të arrini kështu në një kompromis me të gjithë.

**SHIGJETARI**

Planetët do të bëjnë që sot të ndihen më materialistë sesa zakonisht. Por fatmirësisht pozicionimi i Uranit do t'ju ndihmojë që të çloroni fantazinë. Ndoshta zgjedhja që do të bëni nuk është ajo që do të pritej nga ju, por përdorni imagjinatën.

**BRICJAPI**

Një ditë pa shumë bujë. Nëse mendoni se meritoni më shumë, nuk keni bërë logaritë me ata me të cilët duhet të ndani meritat. Në fund do të dini si ta menaxhoni situatën, pasi nuk doni që të dilni keq.

**UJORI**

Ndryshime të shpejta dhe pozitive nga bashkëveprimi i Diellit me Hënën që ju favorizojnë. Në vazhdim e vendimeve të marra, popullariteti juaj do të shtohet. Pak krijimtari dhe fantazi në profesion do t'ju sjellë vlerësimin e një eprori.

**PESHQIT**

Dilni nga kllapia dhe veproni menjëherë, nëse nuk doni që të ngelni mbrapa. Gjë që nuk është kushedi se çfarë, zakonisht. Për të gjetur çelësin e problemit, nevojitet që të keni qetësinë e duhur mendore dhe të mos shpejtoni.

Opinion *i* Ditës

Nga Fisnik ZIÇISHTI

# Ditët e zisë!

(Vijon nga faqja e parë)

... Rrugor. Ai sapo ka mbushur pesë vjeç, por me kureshtjen e një fëmije e vëren fare mirë kur unë mundohem të nxitoj për të vajtur në destinacion dhe gjithmonë më tërheq vëmendjen për të zbatuar rregullat e sjelljes në rrugë, qesh me vete dhe zemra më bëhet mal që im bir më kritikon për këtë problem. Sa herë që lëviz i vetëm në makinë edhe pse ai nuk është me mua zëri i tij me kumbon thellë në mendje si një kabanë që bie fort dhe paralajmëron që rreziku i madh është përpara dhe nuk më lë të gaboj në timon.

Në shqiptarët si popull jemi kockë e fortë jemi mësuar me shumë disfata me ulje dhe ngritje, por këto betejat e fundit po na lodhin shumë si komb.

Në 10 ditshin e fundit rrugët janë përgjakur nga aksidentet automobilistike dhe me dhjetëra shtetas janë plagosur e disa të tjerë kanë humbur jetën, statistikat janë të frikshme shkaqet dihen përdorimi i celularit, shpejtësi tej normave të lejuara, përdorimi pijeve alkoolike mos respektim i rregullave qarkullimit rrugor si dhe një fenomen i tjetër: "zënka në makinë" jemi popull sanguin kur sqarojmë diçka me partnerin mundohemi ta bëjmë në timon. Edhe pse Policia Rrugore po punon mirë, por rezultati lë për të dëshiruar. Dihet e vetme s'mund të bësh asnjë



jë gjë, siç e thotë dhe populli: "Trimi i mirë me shokë shumë". Këtu çalon dhe problemi ku janë aktorët

e tjerë. Ç'po bën Ministria e Arsimit për edukimin e brezave të rinj po ajo e transportit që ka dhe

peshën kryesore që çdo ditë nxjerr me qindra shoferë dhe kalojnë kolaudimin me mijëra mjete

motorike? E ka për detyrë mirëmbajtjen e rrugëve të vendit. Po Instituti i Shëndetit Publik që me fushat sensibilizuese duhet të sensibilizojë gjithkënd nga Vermoshi në Konispol? Po bashkitë që mbledhin taksat do përmitojnë diçka në vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale? Problemet janë të shumta e duan zgjidhje, duhen specialistë të fushës e jo thjesht njerëz me arsim të lartë të punësuar në vende kyçe pa asnjë kualifikim përkatës. Në krahasim me vitin 2016 kemi rënie të kurbës së të vrrarëve në rrugë. Masat administrative të mara nga Policia Rrugore janë në rënie gjë që tregon që drejtuesit e mjeteve janë ndërgjegjësuar dhe po zbatojnë kërkesat e Kodit Rrugor, por përsëri duhet punuar pasi kemi akoma shoferë të cilët nuk duan t'ia dinë për sinjalistikën rrugore dhe pasojat vazhdojnë të jene drithëruese. Dhe kjo për çfarë? Sepse kur hipin shqiptarët në timon thonë: Jam unë më i forti pa e kuptuar që kjo fortësi të çon drejt përplasjes fatale. Pra miq duhet gjakftohësi, duhen edukuar mirë fëmijët që kemi në shtëpi dhe ata që na rrethojnë t'i themi çdo miku e çdo shoku: Hej zbato rregullat e qarkullimit rrugor Kodi Rrugor është i shenjtë është shkruar me gjak, mendo për veten, mendo për familjen tënde, pasi jeta është e bukur dhe duhet jetuar.

\*Specialist i sigurisë rrugore

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



**MBROJTËSI I PËRFAQËSUESËS SHQIPTARE**



Mërgim Mavraj mund ta cilësojë të mbyllur karrierën e tij të Hamburgu dhe të mendojë të sigurojë një klub të ri në verë. Mbrojtësi i përfaqësueses shqiptare, aspak bindës edhe me fanellën kuqezi ndaj Norvegjisë, është përjashtuar nga ekipi i parë, pasi stafi teknik nuk e sheh të nevojshëm për vijimësinë e sezonit. Mavraj kishte dhuruar disa paraqitje me luhatje në fillimin e vitit dhe fillimisht përfundoi në

**Karriera e mbrojtësit në rënie**

**Hamburgu e degdis Mavrajn me ekipin e dytë**

stol, e pastaj në tribunë për ndeshjet e Hamburgut. Përsa me Kombëtaren ishte një mundësi e mirë që mbrojtësi të tregonte vlerat e tij, por paraqitja e tij la shumë për të dëshiruar në këtë duel. Nuk është aspak rastësi që klubi e mori vendimin pikërisht dje, kur

Mavraj duke të kthehej në stërvitje me ekipin e parë. Njëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare është bërë e ditur se futbollisti është larguar nga ekipi i parë. Normalisht, një vendim i tillë zakonisht shoqërohet me largimin në fund të sezonit. "Qendërmbrojtësi

Mërgim Mavraj do të stërvitet me ekipin U21 deri në një njoftim të dytë. Kjo iu komunikua sot në mëngjes nga Kristian Titz, Tomas von Hesen dhe Bernhard Peters. "Për arsye sportive, stafi teknik vendosi që të heqë dorë nga mërgim Mavraj duke filluar që nga dita e sotme. Si rrjedhojë, e kemi udhëzuar që të marrë pjesë në stërvitjet e U21 deri në një lajmërim të dytë", tha Bernhard Peters.

Shtërmenasi u rendit i pari në shkëputje me 146 kg dhe i pari në shtytje me 175 kg

**Briken Calja lahet në ar!  
Kampion i 3-fishtë i Europës**



Jeton Selimi

*Siguroi të artën në dygarësh me 321 kilogramë*

Briken Calja shkëlqen në kampionatin europian të peshëngritjes që po zhvillohet në Rumani. Shtangisti shqiptar arriti të fitojë 3 medalje ari, si kurrë më parë në historinë e shtangës shqiptare, duke ngritur në total 321 kilogramë.

Calja nuk i la shteg askujt në Bukuresht! Peshëngritësi nga Shtërmeni mahnti në pedanë duke siguruar të tria medaljet e arit dhe duke bërë që himni kombëtar të luhet tre herë në sallën e garës! Gara e peshëngritësit tonë në kategorinë 69 kilogramë ishte e mrekullueshme dhe arriti menjëherë të vendosë diktatin e tij, kur në provën e fundit në stilin e shkëputjes arriti të

**FI TORJA**

Momenti i himnit ishte një tjetër moment kulminant. Tre të artat në qafë dhe lotët e Brikenit që në majën më të lartë të podiumit vijon të ndjejë dhimbjet e shpinës, por gëzimi dhe krenaria janë aq të mëdha sa duket sikur djaloshi i artë arrin një fitore të dytë!



ngrejë 146 kilogramë dhe lë pas në vendin e dytë italianin Zani që nuk shkoi përtej 143 kilogramëve. Në stilin e shkëputjes Calja ishte favor-

it absolut, pasi e nisi garën me 174 kilogramë, por situata u ndëllikua nga një problem në shpinë për Shtërmenasin, i cili dështoi në

provën e dytë prej 175 kilogramësh për shkak të dhimbjeve të forta në shpinë. Medalja e arit në dygarësh ishte e siguruar, por

peshëngritësi ynë ka në dorë të bëjë historinë. Briken Calja shtrengon dhëmbët dhe nuk zhgënjën duke siguruar vendin e parë edhe në

shtytje pasi ngre 175 kilogramë dhe me 321 kilogramë në dygarësh lë pas gjermanin Robert Joakim që ngriti në total 311 kilogramë. Në Europeanin e Rumanisë munguan disa vende si Rusia, Bjellorusia, Azerbajxhani dhe Turqia, gjithsesi kjo nuk e zbeh arritjen e madhe të Briken Caljes. Momenti i himnit ishte një tjetër moment kulminant. Tre të artat në qafë dhe lotët e Brikenit që në majën më të lartë të podiumit vijon të ndjejë dhimbjet e shpinës, por gëzimi dhe krenaria janë aq të mëdha sa duket sikur djaloshi i artë arrin një fitore të dytë! Ndërkohë të enjtet do të ngjitet në pedanë një tjetër pretendent, siç është Daniel Godelli!

**SITUATA**

**Ilion Lika fiton gjyqin, ja sa i detyrohet Flamurtari**

Ilion Lika e ka fituar gjyqin me Flamurtarin në Dhomën e Zgjidhjes së Konfliktëve në FSHF. Shuma që ai do të fitojë nga Flamurtar është 37 milionë lekë. Një tjetër gjyq i humbur nga klubi vlonjat, që ndoshta edhe vetë nuk e di në këtë moment sa është fatura totale në këtë drejtim. Portieri Ilion Lika e kishte çuar çështjen e rrogave të pa marra nga Flamurtari në Dhomën e Zgjidhjes së Konfliktëve në FSHF dhe ajo i ka dhënë të drejtë, por nuk i ka njohur rrogat e muajve, kur ai ishte i dënuar nga Komisioni i Etikës. Portieri i Tiranës duhet të përfitojë nga klubi vlonjat 37 milionë lekë



dhe jo 60 milionë, sa ishte shifra e pretenduar prej tij. Lika u dënua nga Etika pas ndeshjes me Partizanin, ku, në fakt, ai nuk ishte farë në fushë për Flamurtarin. Flamurtari ka detyrim të prapambetura financiare ndaj shumë ish-lojtarëve të tij dhe deri në këtë moment

nuk ka ndonjë përpjekje për zgjidhjen e çështjes, ndaj dhe rrezikohet shumë seriozisht licencimi i ekipit vlonjat dhe pjesëmarrja e tij në kompeticionet europiane. Një situatë kaotike dhe me kosto të larta për ekipin, që këtë sezon është shumë pranë sigurimit të një "bilete" për në Europë. Duhet thënë se më parë janë shlyer shumë borxhe të ish-lojtarëve të Flamurtarit nga ana e administratorit Sinan Idrizi, por borxhet duket se nuk mbarojnë kurrë të klubi kuqezi. I fundit i regjistruar zyrtarisht në listë është ky i Ilion Likës.

**Shënoi tre gola kundër Argjentinës**

**Isco: Te Real Madridi nuk më japin besim**




Isco ishte protagonist absolut për Spanjën në fitoren 6-1 në miqësoren kundër Argjentinës. Mesfushori shënoi tre gola dhe bëri një paraqitje mbresëlënëse duke "çmendur" gjithë Spanjën. Trajneri Lopetegui është mrekulluar gjithashtu nga Isco, të cilin ai e ka hedhur pothuajse çdo ndeshje si titullar me Spanjën. Isco është kthyer në titullar i padiskutueshëm në kombëtare, por një gjë e tillë nuk ndodh te Real Madrid. Mesfushori spanjoll, pas miqësore kundër Argjentinës nuk ka lënë pa "thumbuar" trajnerin

e Realit, Zinedine Zidane, duke thënë: "Në kombëtare më japin besim, ndërsa te Real Madrid jo. Kur nuk luan rregullisht me skuadrën

tënde, ndeshjet me kombëtaren të gjallërojnë. Këto janë ndeshje të rëndësishme, sepse dua të tregoj se jam një futbollist i mirë".

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një ditë në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimum.
23. Pak elementarë.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.

37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë.
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

**VERTIKAL**

1. Kanë shpatë të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla.
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve.
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrefimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tujtje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante.
26. Baldwin aktor.
28. Krenar pa gift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshqjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litar.
46. Fillojnë lejen.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij.
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë ilustrimet.
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrtar... qeveritare.
32. Me të nxjerrin trarë.
33. Një shklop, thupër.
37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.

**VERTIKAL**


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tujtje.
15. Fundi i një samuraj.
16. Mbyllën me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe.
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rxihruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullimn aktore.
43. Një brilantinë moderne.
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

P	E	T	R	I	K	A	A	S	P	A	K
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	I	A
T	R	E	R	P	A	N	T	E	R	A	T
B	E	L	S	A	N	D	O	K	A	N	
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	I	H		
P	T	E	O	N	E	K	O	D	R	E	
A	C	T	O	N	E	K	O	A	O	S	
R	A	T	R	A	D	E	E	A	L	M	A
K	E	M	A	P	E	T	E	E	A	P	
E	L	S	A	N	A	L	R	O	N	E	
R	T	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T

**FJALËKRYQI (1)**

M	A	B	U	S	E	H	A	N	E	T	
O	R	E	K	S	B	D	E	M	O	N	I
R	A	S	T	K	A	B	I	R	E	T	P
I	B	A	P	E	R	I	T	O	N	I	T
A	I	K	I	M	B	O	I	R	K		
R	A	S	A	P	A	G	A	N	I	N	I
T	A	V	E	R	R	A	D	O	J	M	A
Y	M	A	R	S	I	A	N	E	T	J	A
H	A	R	A	K	I	R	I	E	R	I	T
A	S	I	T	R	A	D	A	M	E	S	
S	H	A	M	A	T	A	L	O	T	U	S

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

4	7		2		1	8			
	5					3	2		
		5	8	6					
7			2			3	6	1	
	5		8		1		2		
9	1	2			7			4	
			1	9	8		4		
3	2				5	7			
	8	4		7		5		6	

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	5	6	7	9	8	3	1	4	
4	3	9	2	5	1	8	6	7	
7	8	1	4	3	6	5	2	9	
8	6	2	3	4	7	1	9	5	
1	7	4	5	8	9	6	3	2	
3	9	5	6	1	2	7	4	8	
9	1	3	8	7	4	2	5	6	
6	4	7	1	2	5	9	8	3	
5	2	8	9	6	3	4	7	1	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Fëmijet gjejnë gjithçkanë në asgjë, kurse të rriturit asgjënë në gjithçka!  
(Giacomo Leopardi)
- Miku më i madh i së vërtetës është koha, më i madhi armik i saj është paragjykim, ndërsa shoqëruësja e përhershme është përlësia.  
Koltoni
- Fol vetëm atëherë, kur ajo çfarë ke për të thënë është më e bukur se heshtja...
- A s'e sheh që luani rri i heshtur, por nga ai të gjithë janë të frikësuar, e qeni leh pa ndalë por prapë është i përgjuar.  
Imam Shafiu

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

K	S	U	L	T		14	4	9	7	4	19	
8	10	5		1	4	12	2	6	7	5	10	
10	4	7		4	1	2	8	10	6	4	7	5
18				1	7	5	8	9	4	2	10	4
6	5	1		6	2	10	5	2	5		12	
7	1			17	5		1	5	10	17	4	2
2	5	10	17	4	2		4	10	6	15	5	
8	2	8	12		15		6	10	17	5		
18	10	5	16	19		6		4	8		10	1
6		7	5		6	11	5		9	19	6	7
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2		8

M	A	S	H	U	R	K	A		I	R	A	K				
E	S	T	E	R	A		A	D	H	U	N	A				
I	T	E	A	T	E	R		M	I	N						
E	R	A						P	O	L	A	R	T	A		
K	E	L						P	O	L	E	M	I	K	A	T
L								P	O	L	I	G	A	M	I	
E	T	A						P	I	K	A	T	R	E	L	
K	O	M	O					D	E	N	T	O	K	E		
T	R	I						S	E	T	M	N	U	N		
I	T							T	U	T	U		I	T	I	D
K	A	D	E	T				K	O	S	H	L	E			
E	T	I	K					S	E	K	S	E	R	E	T	

*Thënie të mençura*

- Një gabim është vetëm një tjetër mënyrë për të bërë diçka.  
Katherine Graham
- Ne s'kemi asnjë arsye për të qenë krenar me talentin që kemi, ajo që vlen është si e përdorim atë.  
Madeleine D'Engle
- Zhurma nuk provon asgjë. Shpesh një pulë që ka bërë thjesht një vezë, kakarit sikur ka bërë një asteroid. (Mark Twain)
- Mendojnë për të ardhmen me shqetësim, dhe harrojnë të tashmen, nuk e jetojnë të tashmen e as të ardhmen, (i humbin të dyja).

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

